



Bankieri

Botim Nr. 30
Janar 2019

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE



HUAJA BANKARE NJË LËVIZJE DREJTVIZORE

Përdorni kartat bankare për pagesat tuaja!
Më thjeshtë, më shpejt dhe pa komision.



ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

ANËTARËT E AAB-së*



* Nga muaji tetor 2018, sektori bankar shqiptar përbëhet nga 14 banka tregtare.

PËRMBAJTJA

Bankieri

Nr. 30, Janar 2019

Botim i Shoqatës Shqiptare të Bankave



REDAKSIA:

Elvin Meka

Kryeredaktor

Eftali Peçi

Koordinatorë Produksioni

Junida Tafaj (Katroshti)

Bashkëpunëtore

Dorina Zarka

Fotografe**Design & Layout:** FCB AfirmaShtypi nga:  Gent-grafik

Bankieri është publikimi zyrtar i Shoqatës Shqiptare të Bankave i cili i dedikohet kryesisht sektorit bankar shqiptar. Bankieri i jep lexuesit një informacion të vlefshëm mbi arritjet e industrisë në përgjithësi dhe të bankave tregtare në veçanti.

SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Rr. Ibrahim Rugova,

SKY TOWER, 9/3, Tiranë

Tel: +355 4 2280371/2

Fax: +355 4 2280 359

E-mail: bankieri@aab-al.org;

www.aab.al

Editorial

Huaja bankare në Shqipëri - Një lëvizje lineare

Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

5

Tema e Ditës

Ecuria dhe potenciali për rritjen e kreditimit

Klodion SHEHU

6

Intervista

9

Forumi i Ekspertëve

Sistemet e byrove të kredive - sektori financiar dhe ndikimi i tyre ekonomik

James AZIZ

11

Qasja në financim për Ndërmarrjet e Mesme të Vogla dhe Mikro në Shqipëri

Keler GJIKA

21

Rajoni

Financimi i një rritjeje të qëndrueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor - Roli dhe rëndësia e bankave

Dr. Sladjana SREDOJEVIC

23

Sistemi bankar në Malin e Zi - "Fotografia në kornizë"

Nebojša ĐOKOVIĆ, MSc

25

Këndi i Gazetarit

Kreditimi, një vështrim ndryshe

Bardhi SEJDARASI

27

Sistemi Bankar

Krimi kibernetik, kërcënimi dhe rreziku

Dr. Hergis JICA

30

Bashkëpunimi publik - privat në ndërgjegjësimin rreth rreziqeve kibernetike - Fushata e

EBF - Europol-it kundra mashtrimeve kibernetike

Alexandra MANIATI

32

Këndi i Ekonomistit

Problematika dhe strategjitë në kuadrin e Unionit Bankar Evropian për garantimin e depozitave dhe uljen e rrezikut të huave me probleme

Prof. Dr. Adrian CIVICI

35

Objektivat për Zhvillim të Qëndrueshëm

39

AAB: Aktivitete - Trajnime

43

BORDI EDITORIAL:

Silvio PEDRAZZI

Kryetar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Intesa Sanpaolo Bank Albania

Dritan MUSTAFA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Tirana Bank

Ervin KOÇI

Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikqyrjes Financiare

Adela LEKA

Nënkryetare e Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtuese e Drejtorisë Ekzekutive, Procredit Bank

Andi BALLTA

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, American Bank of Investments

Adrian CIVICI

President i Universitetit Europian të Tiranës

Hysen ÇELA

Kryetar i Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar

Maltin KORKUTI

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Credins Bank

Bozhidar TODOROV

Anëtar i Bordit Drejtues të AAB-së & Drejtor i Përgjithshëm, Fibank Shqipëri

Spiro BRUMBULLI

Sekretar i Përgjithshëm, Shoqata Shqiptare e Bankave

Ëndrrat e tyre një ditë mund të bëhen realitet!



DEPOZITA "SMILE"

- Norma të larta interesi
- Monedhat e hapjes së depozitës janë LEK, EUR, USD
- Përfitoni interes për çdo shumë shtesë

www.abi.al

abi
AMERICAN BANK
OF INVESTMENTS

Huaja bankare në Shqipëri

Një lëvizje lineare

Nisur nga karakteristikat e vendit tonë, një përfshirje më e madhe financiare kërkon më shumë edukim financiar dhe infrastrukturë më të sofistikuar të tregut financiar. Në këtë drejtim, edukimi financiar mund të shndërrohet në një levë të dobishme për një përfshirje më të madhe financiare.



Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA¹

Kryeredaktor

Kur vështrime tablonë e huas për ekonominë (kryesisht huadhënien bankare) gjatë vitit 2018 dhe treguesit të përgjithshëm ekonomikë, në mënyrë të pashmangshme na ngrihet një pikëpyetje: tashmë kemi realizuar një rritje ekonomike pozitive (4%+), me më pak hua për ekonominë, ku kjo e fundit shënoi një rënie neto prej më shumë se 20 miliardë lekësh, me bazë vjetore! Në fakt, kjo nuk është thjesht një shifër, e mbi të gjitha, jo nga ato që mund të neglizhohet. Megjithëse tabloja e mësipërme për huadhënien bankare dhe huan për ekonominë në përgjithësi nuk është e saktë, nuk ka vend për shumë entuziazëm nëse e lexojmë me kujdes atë. Mendimi i përgjithshëm rreth huadhënies për ekonominë është se bankat nuk po japin hua e nuk po e mbështesin ekonominë me fonde të mjaftueshme, për të siguruar investimet e dëshiruara.

Në të vërtetë, bankat e kanë kredituar ekonominë pa ndërprerje, pavarësisht se statistikat nuk e "mbështesin" këtë fakt. Nëse lexohet mes rreshtash, kuptohet lehtë se huat e reja për ekonominë janë "eklipsuar" vazhdimisht nga shlyerjet e huave ekzistuese dhe jo vetëm. Në këndvështrimin e "aritmetikës mekanike", "gomat e mëdha" që kanë fshirë thujse plotësisht efektin pozitiv të huave të reja nga portofoli i huave bankare për vitin 2018, ishin rivlerësimi i lekut dhe procesi i fshirjes së huave me probleme. Thënë kjo, realiteti bëhet tashmë më i qartë, por ai konfirmon se huaja për ekonominë i ngjan një lëvizjeje drejtvizore të njëtrajtshme dhe jo të përsheptuar, siç mund të ketë pritur, shpresuar, dëshiruar apo parashikuar gjithkush. Kjo "lëvizje" e huas bankare lidhet me disa faktorë organikë, si: kreditimi i biznesit mbi bazën e pasqyrave financiare zyrtare, standardet e forta të huadhënies, mungesa e projekteve të realizueshme dhe cilësore nga biznesit dhe më pak "oreks" nga ky i fundit për t'u financuar me hua bankare, kalibrimi më i mirë i procesit të menaxhimit të rrezikut në gjithë sektorin bankar, ku të gjithë së bashku ndikojnë thellë e në vijim mbi portofolin e huave bankare. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, konsolidimi i sektorit i dha shtysën e fundit kësaj "lëvizjeje lineare", duke e riorientuar fokusin e palëve të interesuara në konsolidim drejt çështjeve institucionale dhe strategjike, por disi larg nga rritja progresive e huave.

Kur të gjithë këta faktorë organikë

vendosen në peizazhin aktual makroekonomik, që ofron rritje pozitive ekonomike, në kontekstin e një mos-ndërmjetësimi relativ financiar, demografisë në rënie, industrializimit bazik të ekonomisë, bujqësisë masivisht të nënfinancuar, ekonomisë gri ende të madhe, sundimit të dobët të ligjit dhe problematikave me titujt e pronësisë, huaja për ekonominë kthehet në një sipërmarrje komplekse për sektorin bankar shqiptar. Kur të gjithë këto fakte shoqërohen me konsolidimin e vazhdueshëm të sektorit, atëherë kjo kthehet në një sfidë afatgjatë, që duhet të trajtohet siç duhet e në harmoni të plotë me prioritetet kryesore të palëve të tjera në ekonomi, zakonisht të qeverisë dhe politikës, të cilat duhet të shpallin dhe shpalsin qartë objektivat dhe prioritetet strategjike për ekonominë dhe shoqërinë shqiptare, përtej mandateve të zakonshme politike. Bankat janë në treg për të dhënë hua e për të mbështetur ekonominë dhe shoqërinë me fonde dhe likuiditete të mjaftueshme, si dhe me ekspertizë e përvojë cilësore, që biznesi dhe konsumatori të përballojë sfidat ekonomike dhe jo-ekonomike, por përderisa jetojmë dhe punojmë në një ekonomi tregu, thujse gjithçka nxitet nga kërkesa dhe tregu dhe bankat nuk mund t'i shpëtojnë një aksiome të tillë, por ato do bëjnë gjithçka për të ofruar më të mirën e mundshme!

¹Zv.Rektor, Universiteti Europian i Tiranës, UET

Ecuria dhe potenciali për rritjen e kreditimit

Kreditimi më i mirë për sektorin bankar dhe për ekonominë, është ai që rezulton eficient. Kjo do të thotë që në këtë proces të gjitha palët e përfshira duhet të jenë të interesuara dhe të sigurojnë që bankat të udhëhiqen nga standardet më të mira të analizës, të vlerësimit të rrezikut, të monitorimit dhe të mbledhjes së huas.



Klodion SHEHU

Drejtor, Departamenti i Stabilitetit Financiar
BANKA E SHQIPËRISË

Kreditimi i subjekteve ekonomike private (familje/individë dhe ndërmarrje) mbetet një nga veprimtaritë kryesore të një banke tregtare (dhe të një sektori bankar tradicional), përmes së cilës përdoren në mënyrë efektive burimet e ndryshme të financimit (p.sh.: depozitat e publikut), gjenerohet pjesa më e rëndësishme e të ardhurave të institucionit (sektorit) dhe kontribuohet në zhvillimin ekonomik të vendit.

Pas vitit 2008, normat e rritjes vjetore të kreditimit nga ana e sektorit bankar në vend kanë ardhur në rënie të theksuar. Kjo rënie e evidenton jo vetëm ritmin e lartë të kreditimit në periudhën 2005-2007, por edhe pasojat e goditjes

që pësuan sektorë, që deri atëherë kreditoheshin në vlera të larta (p.sh.: ndërtimi), të ngadalësimit të rritjes ekonomike në tërësi, të rritjes së rrezikut të kreditit dhe të shtimit të kujdesit nga bankat, në analizën e mundësive të financimit.

Disa tregues e konfirmojnë rënien e ritmeve të kreditimit. Kështu, të dhënat e raportuara rregullisht nga bankat për tepricën e kredisë në bilancet e tyre, tregojnë që norma vjetore e rritjes së kredisë, që ishte mbi 35% në 2008, ka zbritur në rreth 15% në 2011, shënoi vlerën negative (tkurrje) prej 1.5% në 2015 dhe theksoi tkurrjen, duke shënuar vlerën negative 3.5% në tremujorin e tretë të 2018. Fokusimi vetëm në ecurinë e vlerave nominale të tepricës së kredisë bankare, mund të çojë në vlerësim të pasaktë të vlerave të kredisë që ka përfituar ekonomia, pasi nuk dallon ndikimin që kanë pasur procese të caktuara (disa me efekt të përkohshëm), siç mund të jenë kreditimi për subjektet jo-rezidente, fshirjet nga bilancet e bankave të huave të humbura, kontributin që japin në kreditim institucionet financiare jo-bankare, apo edhe efektin pakësues të mbiçmimit të kursit të këmbimit të monedhës vendase (në të cilën raportohen vlerat e kredisë, duke përfshirë edhe atë në valutë). Për Shqipërinë, këto procese kanë qenë të rëndësishme, veçanërisht duke nisur nga viti 2015. Për shembull,

që atëherë dhe deri në tetor 2018, vlerësohet se bankat kanë fshirë nga bilancet e tyre rreth 55 miliardë lekë kredi me probleme (kryesisht, të humbur). Koncepti i "kredisë për ekonominë"¹, duket se i konsideron në mënyrë më të përshtatshme këta faktorë. Kur rregullohet për efektin e fshirjeve dhe për efektin e kursit të këmbimit, ecuria e kredisë për ekonominë rikonfirmon një moderim të theksuar të kreditimit, por në ndryshim nga ecuria e vlerës nominale të kreditimit, rritja vjetore e kredisë për ekonominë mbetet në vlera pozitive. Për të njëjtat periudha kohe, kjo rritje vjetore ishte përkatësisht 33%, 12%, 2.8% dhe 1.8%. Si rezultat, raporti i Kredisë për Ekonominë/PBB, shënon një rënie më të lehtë, nga niveli 41% i PBB në 2010, në rreth 37% të PBB në shtator 2018.

Për të pasqyruar faktorët ciklikë në ndryshimin e kreditimit, një tregues më i përshtatshëm do të ishte krahasimi i raportit: "Kredi për ekonominë/PBB" në një moment të caktuar, me prirjen e tij afatgjatë. Kjo diferencë, e njohur ndryshe si "hendeku i kredisë ndaj PBB-së", vlerësohet paraprakisht të jetë rreth -11% për Shqipërinë. Kjo do të thotë, që kreditimi nuk ka "ndjekur" rritjen ekonomike të vendit, ose e thënë ndryshe që rritja ekonomike në dhjetëvjeçarin e fundit nuk është mbështetur si më parë nga kreditimi i sektorit financiar.

¹ Kredia për ekonominë, krahas kredisë së dhënë nga bankat përfshin edhe kredinë e dhënë nga institucionet financiare jo-bankare; në vlerën e saj përfshihet vetëm sektori privat rezident dhe vlera e saj nuk ndikohet nga fshirjet e huave me probleme nga bilancet e bankave [këto kredi janë përfituar tashmë nga subjektet ekonomike dhe kanë ndikuar në vlerën ekonomike të tyre; fshirja e tyre e mëvonshme nga bilancet e bankave nuk e ndikon këtë fakt].

Në këtë drejtim, zhvillimet në Shqipëri janë të ngjashme me ato të zonës së Bashkimit Europian dhe të Ballkanit Perëndimor. Pas krizës financiare globale të vitit 2008, edhe këto rajone përjetuan atë që përkufizohet si "rritje pa kredi". Kjo gjendje përcaktohet si një situatë ku rënia e vlerës së aktiveve në ekonomi përkon me procesin e uljes së borxhit nga agjentët ekonomikë që veprojnë në sektorët e mbifinancuar dhe me aftësi paguese të dëmtuar. Kjo spirale rënëse në vlerat e financimit, ruan ndikimin e saj edhe kur rinis procesi i gjallërimit ekonomik, duke krijuar kështu një ecuri në kahe të ndryshme të kredisë dhe të PBB-së. Sidoqoftë, vlerat e hendekut të kredisë ndaj PBB-së për vendet e këtyre rajoneve (BE, Ballkani Perëndimor) kanë qenë përgjithësisht në vlera të ulëta pozitive ose negative. Për më tepër, në disa prej këtyre vendeve, duke përfshirë edhe të Ballkanit Perëndimor, në 2-3 vitet e fundit ky hendek ka shfaqur vlera pozitive në rritje duke treguar një përshpejtim të kreditimit, mbi vlerat e rritjes afatgjatë të PPB-së.

Përse Shqipëria shfaqet disi më e veçuar se vendet e tjera të rajonit, në drejtim të ecurisë/rritjes së kreditimit? Disa nga arsyet mund të jenë:

a) bankat vlerësojnë që rreziku i kreditit mbetet ende i konsiderueshëm, ndonëse raporti i huave me probleme ka rënë në mënyrë të ndjeshme. Ndryshimet ligjore për lehtësimin e procesit të ekzekutimit të kolateralit dhe funksionimin e zyrave private të përmbartimit, kërkesa rregullative për fshirjen nga bilanci i bankave të huave të humbura prej më shumë se 3 vjetësh, veprimet për uljen e përqendrimit të huave me probleme, masa të tjera në kuadër të Planit Kombëtar për uljen e huave me probleme, si edhe veprimet më aktive të bankave në drejtim të

ristrukturimit, shitjes dhe mbledhjes së këtyre huave, kanë ndikuar në përgjysmimin e raportit të huave me probleme, nga 25% në fund të vitit 2014, në rreth 12.5% në fund të vitit 2018. Megjithatë, niveli aktual mbetet ende i lartë dhe ndikon që bankat të mbeten përgjithësisht hezituese në përzgjedhjen e projekteve që financojnë, veçanërisht të ndërmarrjeve. Kjo është e dukshme edhe në përgjigjet që bankat japin në vrojtimit e posaçme të Bankës së Shqipërisë, ku evidentohen kushte të shtrënguara të kreditimit në këtë sektor. Në vijim, bankat vijojnë ta konsiderojnë procesin e ekzekutimit të kolateralit si ende problematik dhe ky vlerësim ka ardhur në përkeqësim që prej vitit 2016. Marrja në bilancin e bankave të kolateraleve (kryesisht prona të paluajtshme) të humarrësve të dështuar, ka rritur kostot operacionale dhe i ka ekspozuar ato ndaj ineficiencave me të cilin funksionon tregu i pasurive të paluajtshme. Për të adresuar pasiguritë në këtë treg, bankat janë të prirura të kërkojnë vlera më të larta të kolateralit nga huamarrësit, ose zgjedhin të mos pranojnë kërkesat e tyre për financim.

b) ndikimi i përkeqësimit të cilësisë së portofolit të huas mbi të ardhurat e sektorit bankar ka qenë deri tani i përballueshëm, duke kufizuar në këtë mënyrë stimujt e bankave për të zgjeruar kreditimin në kushtet e rreziqeve të pranishme. Në këtë drejtim, ka ndihmuar përbërja e aktiveve të bankave, ku investimet në tituj (duke përfshirë edhe ato të borxhit të qeverisë shqiptare) zënë rreth 24% të totalit të aktiveve, më i larti në rajon. Në këto nivele, të ardhurat nga ky portofol amortizojnë në një masë të ndjeshme kostot që burojnë nga përkeqësimi i cilësisë së portofolit të huas. Efekti ka qenë më i madh në gjysmën e parë të dhjetëvjeçarit të fundit, kur normat e kthimit nga investimet në tituj kanë

qenë më të larta. Pas lehtësimit të ndjeshëm të politikës monetare dhe procesit të konsolidimit fiskal, kontributi i portofolit të titujve të ardhurat e bankave ka ardhur në rënie ndërsa ai i rimarrjes së fondeve rezervë për rrezikun e kreditit (provizioneve) ka ardhur në rritje;

c) ndryshimet strukturore në portofolin e kredisë dhe në kapacitetet e brendshme të bankave, kanë qenë të pamjaftueshme për të mbështetur një rigjallërim të shpejtë të kreditimit. Çështja është nëse bankat kanë qenë aktive për të orientuar kreditimin drejt sektorëve të rinj me potencial zhvillimi. Ky është një proces kompleks, i cili ndërthuret me politikat ekonomike afatgjata të zhvillimit të vendit dhe që kërkon kohën e tij për t'u realizuar, ndaj një vlerësim i shkurtër rrezikon të thjeshtojë në mënyrë të paarsyeshme procesin. Megjithatë, të dhënat duket sikur tregojnë që bankat kanë qenë më të angazhuara me shërbimin e portofolit ekzistues të huas, sesa me eksplorimin e potencialeve të reja për huadhënie. Kështu, vlerat vjetore të huas së re kanë mbetur në nivele të ngjashme me ato të vitit 2010, përqendrimi i huas në sektorin e biznesit ka pësuar vetëm një ulje me 3 %, krahasuar me nivelin e vitit 2010, ndërsa brenda këtij portofoli ndërmarrjet e vogla dhe të mesme vijojnë të ndeshen me kërkesa relativisht më të shtrënguara për financim. Përbërja e stokut të huas sipas sektorëve të ekonomisë nuk ka shënuar ndryshime të ndjeshme, ndërkohë që sektorë si: bujqësia dhe industri ndihmëse të saj, mbeten të nënfinancuara nga sektori bankar. Ndërkohë, bankat dhe huamarrësit kanë rritur preferencën për huadhënien në lek, të nxitur nga rënia e normave të interesit të huas, në vijim të politikës monetare lehtësuese të Bankës së Shqipërisë. Gjithashtu bankat janë angazhuar në procesin e largimit të huave të

humbura nga bilancet e tyre, duke përfshirë edhe shitjen e portofoleve të caktuara në subjekte financiare jo-bankare;

d) objektivat për përmirësimin e pozicionit të kapitalit në nivelin e grupeve bankare europiane, në vijim të krizës financiare globale të 2008, janë përkthyer në sjellje me pasive të filialeve të tyre edhe në vendin tonë. Kjo sjellje është shoqëruar me mosrritjen, apo uljen e ekspozimeve/ investimeve në aktive lokale dhe ulje të kostove operacionale nga këto banka; pra, në realitet është vërejtur më pak angazhim për financime të reja në sektorët privat e publik dhe riorganizim i veprimtarisë me objektiv ruajtjen e "status-quo"-së. Në fakt, në 2010 bankat me origjinë nga Bashkimi Europian zinin rreth 76% të vlerës së stokut të huas së sektorit bankar, ndërsa në qershor 2018 kjo peshë kishte rënë në rreth 53%. Gjatë kësaj periudhe, secili nga grupet e bankave me origjinë të kapitalit jashtë Bashkimit Evropian dhe me kapital shqiptar, kanë qenë më aktiv në kreditim dhe pothuaj kanë dyfishuar peshën e vet në portofolin e huas, në rreth 23%. Nëse kjo prirje vijon edhe në të ardhmen, kontributi në kreditim me ritme të ngjashme nga këto banka do të kërkojë fuqizim të pozicionit të tyre të kapitalit. Sidoqoftë, pesha e grupeve bankare europiane do të mbetet kryesore dhe si e tillë, rritja e qëndrueshme e huadhënies do të kërkojë angazhimin e tyre;

e) komunikimi me bankat si edhe disa vrojtime të drejtpërdrejta me familjet dhe ndërmarrjet, sugjerojnë që kërkesa për hua nga sektori real i ekonomisë është e moderuar. Bankat evidentojnë pamjaftueshmërinë e projekteve të reja të vlefshme për financim. Kjo gjë rezulton edhe nga vrojtimet më të fundit të Bankës së Shqipërisë për gjendjen financiare dhe huamarrjen e familjeve dhe të ndërmarrjeve, ku "oreksi" i tyre për

huamarrje paraqitet i moderuar. Pavarësisht problematikës, duhet theksuar që potenciali për kreditim të ekonomisë nga sektori bankar është i konsiderueshëm. Në fakt, raportet e kredisë ndaj PBB-së në Shqipëri, janë dukshëm më të ulëta se vendet e tjera të ngjashme të rajonit dhe ndryshimi është edhe më i fortë me mesataren e vendeve të BE-së.

Si faktor mbështetës i kërkesës për hua veçohet përsheptimi i rritjes ekonomike në vend, duke qenë aktualisht ndër më të lartët në rajon. Kjo rritje ekonomike duhet të shoqërohet me rritje të të ardhurave të familjeve dhe të ndërmarrjeve dhe rritje të kërkesës për investime. Ndërkohë, kapacitetet huamarrëse dhe përballeshmëria e borxhit nga agjentët ekonomikë në Shqipëri vlerësohet si e përshtatshme. Kështu, sipas vrojtimeve të gjendjes financiare dhe huamarrjes për ndërmarrjet dhe familjet në 6m-I 2018, më shumë se gjysma e ndërmarrjeve nuk financohen nga bankat, për afërsisht ¾ e ndërmarrjeve huamarrëse vlera totale e huasë rezulton sa gjysma e vlerës së kapitalit të ndërmarrjes dhe pagesa e huasë arrin deri në 20% të të ardhurave të saj. Për familjet, në bazë të vrojtimeve të mësipërm për periudhën, rezulton që më pak se 1/3 e tyre kanë borxh për të paguar dhe se për rreth ¾ e këtyre familjeve kësti i borxhit nuk i kalon 30% të të ardhurave mujore. Pra mundësia e zgjerimit të huamarrjes nga sektori real i ekonomisë është e pranishme, në kushtet e ekzistencës së kapaciteteve për mbajtjen dhe shërbimin e tij. Nga ana e ofertës për kreditim, gjendja financiare dhe burimet e sektorit bankar vlerësohet se mund të mbështesin nivele ndjeshëm më të larta të kreditimit. Këtu dallohen prania e lartë e aktiveve likuide dhe raporti i ulët të huas ndaj depozitave (rreth 51%). Prania e lartë e likuiditeteve

në bilancin e sektorit bankar shqiptar e vendos atë në pozicionin më të favorshëm në rajon, për një përsheptim të kreditimit. Mbetet domosdoshmëri që ky potencial të shfrytëzohet, duke identifikuar veprimet e nevojshme nga të gjitha palët e interesuara.

Për shembull, konsolidimi fiskal dhe ulja e borxhit të qeverisë është një politikë e cila i nxit bankat të kërkojnë sektorin privat për përdorimin efektiv të burimeve financiare që çlirohen. Riorientimi i mundshëm i burimeve financiare drejt kreditimit, ose edhe përsheptimi i proceseve të shitjes, apo të ristrukturimit efektiv të huave me probleme, do të duhej të shoqërohej edhe me vlerësimin e vazhdueshëm të përshtatshmërisë së nivelit të kapitalit nga bankat. Nga ana tjetër, rigjallërimi i kreditimit do të kërkonte praninë e projekteve të vlefshme të financimit. Bankat mund të bëjnë më shumë në drejtim të identifikimit, apo edhe asistimit të klientëve, për zhvillimin apo përsosjen e këtyre projekteve, por hapësira e bankave në këtë drejtim është objektivist e kufizuar. Rol parësor do të kishin politikat ekonomike dhe financiare të cilat, edhe më tej, duhet të përfshijnë: përmirësimin në mënyrë të ndjeshme të klimës së biznesit, nxitjen e krijimit të ndërmarrjeve të reja dhe zbatimin efektiv të përcaktimeve ligjore për daljen pa vonesë nga tregu, apo ristrukturimin thelbësor të ndërmarrjeve të dështuara; zbutjen e rrezikut të kreditit në sektorët me përparësi zhvillimi dhe përmirësimin e aksesit në financim për ndërmarrjet e vogla e të mesme; apo dhe diversifikimin e llojeve të kolateraleve drejt atyre të luajtshëm dhe zgjerimin e përdorimit të tyre. Veprimet më konkrete që mund të ndërmerren në këtë drejtim, kanë nevojë të diskutohen dhe të analizohen mes palëve.

INTERVISTA

Viti 2018 u mbyll dhe kredia për ekonominë mbetet ende në nivele jo të kënaqshme. Në këndvështrimin e bankës suaj, cilët janë faktorët kryesorë të stanjacionit të kredisë dhe perspektiva për rritjen e portofolit të kredive dhe vet kredinë për ekonominë, gjatë vitit 2019?



Georgios PAPANASTASIOU

Drejtor i Përgjithshëm
ALPHA BANK ALBANIA

Kur bankat perceptojnë rreziqe relativisht të larta të likuiditetit dhe të besueshmërisë, e në përgjigje projektojnë humbje të mundshme në të ardhmen, ato mund të rrisin kapitalin, nëse është e mundur, ose zvogëlojnë ekspozimet e

tyre, nëpërmjet heqjes/uljes së portofolit të huas (vlerës së totalit të bilancit) të tyre. Meqenëse shtesa e kapitalit, nga burime të brendshme ose të jashtme, pas krizës së fundit ishte thuajse e pamundur, atëherë ulja e ekspozimit ndaj huave ishte thelbësore për përshtatjen e ekspozimeve ndaj rrezikut në përputhje me kapitalin ekonomik dhe rregullator të bankave. Ky veprim duhet të shihet si masë standarde dhe e arsyeshme që ka siguruar stabilitetin e sektorit bankar dhe stabilitetin financiar në vend.

Kriza e fundit financiare globale tregoi edhe një herë se, nga njëra anë, qëndrueshmëria e sektorit bankar varet nga zhvillimi i qëndrueshëm i ekonomisë reale dhe, nga ana tjetër, rritja e qëndrueshme ekonomike dhe zhvillimi i qëndrueshëm i vendit varet nga shëndeti i sistemit bankar. Nga kjo perspektivë, gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, kredia për ekonominë ishte në përputhje me

objektivat e stabilitetit të sistemit bankar dhe atij financiar.

Parashikimet aktuale ekonomike dhe perceptimi se rreziku i likuiditetit dhe i besueshmërisë janë rikthyer në nivele normale, përbëjnë elemente mbështetëse për rritjen e veprimtarisë huadhënëse. Rritja e depozitave do të financojë rritjen e parashikuar ekonomike, në vitet e ardhshme. Prandaj, janë të arsyeshme zhvillimet e pritshme pozitive të huadhënies gjatë vitit 2019, në përputhje me rritjen ekonomike. Bankat, që sot janë më të mirë-kapitalizuara, janë të gatshme të përdorin likuiditetin e tepërt për të financuar projekte të qëndrueshme publike dhe private dhe të kontribuojnë pozitivisht për ndryshimin e sjelljes konsumatore të publikut.

American Bank of Investment (ABI Bank) vazhdon të rrisë praninë e saj në industrinë bankare, nëpërmjet rritjes organike dhe mekanike.

Nga këndvështrimi ynë, arsyet për një situatë stanjacioni në huadhënie janë disa, si më poshtë:

1 - Ulja e ekspozimit ndaj huadhënies në rrafsh global dhe rajonal nga bankat e mëdha dhe sidomos problemet me sistemin bankar në Evropë, pas vitit 2008, pati një ndikim të fortë dhe efekt të vonuar në Shqipëri. Thuajse të gjitha bankat evropiane të pranishme në vend ndoqën strategjitë e ruajtjes së kapitalit dhe/ose të tërheqjes

nga degët periferike. Duke qenë se këto banka përfaqësojnë mbi 50% të sektorit bankar shqiptar, strategjitë e tyre të ruajtjes së kapitalit dhe daljes kishin pasoja të drejtpërdrejta në reduktimin e huadhënies dhe konsolidimit të sektorit bankar (i cili gjatë vitit 2018 arriti nivelin më të lartë). Një konsolidim i tillë përfshinte pothuaj 20% të sektorit bankar dhe ndikoi në rritjen e tij në përgjithësi. Bankat që donin të shiteshin, filluan të shesin dalëngadalë veprimtarinë e tyre të huadhënies si dhe u përqendruan në pastrimin e bilanceve. Nga ana tjetër, bankat që po i blinin ato, i dhanë, në afat të shkurtër, përparësi transformimit të



Andi BALLTA

Drejtor i Përgjithshëm
AMERICAN BANK OF INVESTMENT

bankës së përthithur.

2 - Është tërësisht racionale që financimi i mundësive të investimit/ rritjes ekonomike të arrihet përmes një kontributi më të madh me kapital të vet, pas një periudhe të gjatë huadhënie, e me nivele të larta të huave me probleme. Status-quo-ja, ku aksionarët ndërkombëtarë financuan për vite me radhë humbjet e filialeve të tyre në Shqipëri, do të përfundonte një ditë. Historia e humbjeve do të vazhdojë të ketë ndikim mbi bankat, të cilat do vijojnë të jenë konservatore në praktikat e tyre të huadhënies.

3 - Fqinjët më të mëdhenj dhe tradicionalë të Shqipërisë, Italia dhe Greqia, kanë raportuar rritje të dobët ekonomike, nivel të lartë

të huave me probleme dhe gjendje të paqëndrueshme financiare. Këta faktorë kanë ndikuar negativisht në kërkesën për hua në Shqipëri.

4 - Shqipëria ka tashmë një rritje demografike negative. Kjo ka ndikuar gjithashtu negativisht edhe në kërkesën për hua.

5 - Ekziston një nevojë më e madhe për investime në infrastrukturë, nga subjektet ndërkombëtare dhe ato qeveritare, veçanërisht në turizëm dhe bujqësi. Përpjekjet përmes PPP-ve do të kenë një ndikim pozitiv në huadhënie. Sigurisht, cilësia dhe ritmi i punimeve që nevojitet për të rritur besimin e investuesve, përmes mundësive të investimeve të qëndrueshme dhe rentabël, do të jenë

pika e infleksionit në këtë drejtim.

6 - Gjatë vitit 2019, përpara rregullatorëve shtrihet një detyrë shumë e rëndësishme dhe sfiduese për ruajtjen e stabilitetit të sektorit bankar, përgjatë gjithë dhjetëvjeçarit të ardhshëm. Formula e bankave të mëdha ndërkombëtare që mbajnë stabilitetin e sektorit bankar ngadalë do i lërë vendin një interesi më të madh për pjesëmarrje të kapitalit vendas në sistemin bankar shqiptar. Një dinamikë e tillë do të vazhdojë të favorizojë një qasje konservatore dhe një "oreks" të pakët për huadhënie. Nisur nga kjo, ka shumë mundësi që rritja e huadhënies do të ndjekë me një ritëm më të lartë rritjen ekonomike gjatë 2019-ës.



Seyhan PENCABLIGIL

Drejtor i Përgjithshëm
BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Faktorët kryesorë për vitin 2018

Para së gjithash, shumica e huave janë dhënë në euro. Kur analizohet prirja vjetore e gjithsej huave bankare, edhe sikur të merren në konsideratë vetëm shifrat në lek për vitin 2018, ato mund të jenë disi çorientuese.

Mbiçmimi i fortë i lekut ndaj euros (nga 135 lekë në 123 lekë) krijon një përshtypje të rreme lidhur me shifrat totale të huas dhe duket sikur nuk ka

rritje, por rënie. Një tjetër parametër i rëndësishëm që duhet marrë parasysh është shlyerja e huave. Nëse marrim një kohëzgjatje mesatare të huas prej katër vjetësh, në rast se nuk jepen hua të reja, atëherë portofoli i përgjithshëm do të pakësohet me 25%, megjithatë gjendja nuk është kështu. Përveç kësaj, vihet re një mungesë kërkesë dhe projektsh të financueshme. Viti 2018 ishte një tjetër vit ku nivelet e investimeve private ishin veçanërisht të ulëta. Rezultati ishte mungesa e projekteve investuese të realizueshme dhe premtuese. Thënë kjo, besoj se shumica e bankave janë gati të financojnë projektet e duhura. Gjithashtu, duhet të theksohet se filialet e grupeve bankare ndërkombëtare janë prekur nga vendimet e mëmave të tyre dhe/ose autoriteteve në vendet përkatëse.

Perspektivat për vitin 2019

Për 2019-ën pritet:

- që shteti të rrisë nivelin e kontrollit fiskal, në mënyrë që të ulët informaliteti, veçanërisht në sektorët kyç të ekonomisë.
- përfundimi i reformës në gjyqësor, që shpresohet se do

të zvogëlojë nivelin e pasigurisë ligjore dhe korrupsionit, si dhe do të rivendosë besimin te institucionet.

- që prioriteti për investimet e (realizueshme) në infrastrukturë të mbështesë industrinë e turizmit dhe bujqësinë, jo vetëm për të rritur numrin e turistëve që vijnë në Shqipëri, por edhe për të zgjatur sezonin turistik, sikundër në vendet e tjera fqinje.

- një klimë e përshtatshme biznesi për segmentin e korporatave, për të zhvilluar projekte të realizueshme dhe të mundshme për financim.

- nxitje fiskale dhe kuadër ligjor i përshtatshëm për investuesit e huaj, në mënyrë që ata të vijnë dhe të investojnë në Shqipëri. Në këtë kuptim, stimujt e dhënë në Maqedoni dhe Serbi mund të shërbejnë si shembuj me këtë rast.

Sektori bankar në Shqipëri është i shëndetshëm, likuid dhe i mirë-kapitalizuar. Shumica e bankave janë në gjendje dhe të gatshme të financojnë projekte të mira. Ne, si BKT, e kemi prioritet dhe shpresojmë të rrisim portofolin tonë të huas në mënyrë të konsiderueshme gjatë vitit 2019.



Maltin KORKUTI

Drejtor i Përgjithshëm
CREDINS BANK

Në Credins Bank nuk flasim për stanjacion gjatë vitit 2018, por për rritje të moderuar dhe të kujdesshme. 2018-ta është karakterizuar nga një gjallërim i strukturimeve të sektorit bankar dhe me sfida në përmirësimin e treguesve financiarë. Fokusi ka qenë të mbajtja në nivele të përshtatshme të ekspozimit në rrezik ndaj kreditimit dhe, njëkohësisht, rritja dhe mbështetja me financime për biznesin e vogël dhe të mesëm. Diversifikimi i portofolit të huave të bankës, si ndaj sektorëve të ekonomisë dhe ndaj monedhave të huave, kanë kontribuar në arritjen e objektivit të bankës për këtë vit. Qasja e përshtatshme ndaj kreditimit, e orientuar nga strategjia e bankës për fuqizimin e kreditimit në monedhën vendase dhe në sektorët me zhvillim potencial në rritje, e njëkohësisht nga vet kërkesa e klientelës, si bizneseve dhe individëve, kanë bërë të mundur vazhdimin e rritjes së kreditimit të bankës me ritme të mira përgjatë këtij viti.

Faktorë që kanë dhënë një ndikim negativ në rritjen e

portofolit të huave gjatë vitit mund të përmenden: ristrukturimet e bankave për portofolin problematik, procesi i fshirjes së huave, ri-negocimi dhe gjetja e burimeve të tjera të financimit jashtë sektorit bankar vendas prej institucioneve publike, dhe nënçmimi i konsiderueshëm i monedhës evropiane ndaj lekut, që ka sjellë një tkurrje të volumit në kundërvlerë të huave në monedhë të huaj. Ndërkohë, një kërkesë e zbehtë nga bizneset për financime, veçanërisht për bizneset e mëdha, e shoqëruar me kushte të pandryshuara të kreditimit nga ana e bankave për këtë segment, kanë bërë që të ketë një ecuri me ritme tepër të ngadalta të financimit të tyre. Qasja e përgjithshme e sektorit ndaj korporatave, sipas mendimit tonë, mbetet në nivele të kujdesshme dhe e fokusuar në përmirësimin e portofolit ekzistues, si dhe në kërkimin e projekteve të përshtatshme me oreksin për rrezik të bankave.

Ecuria pozitive e fondeve për bankat në vend dhe, veçanërisht, e depozitave të sektorit, ka krijuar një mjedis me likuiditete të përshtatshme dhe me hapësirë me të madhe për kreditim. Gjithashtu, nevoja në rënie për financim të brendshëm nga ana e qeverisë në periudhën e fundit të këtij viti, krijon kushte për kalim të fondeve të disponueshme në hua për ekonominë. Në këtë situatë, të gjendjes së mirëkapitalizimit dhe likuiditeteve të sektorit bankar, vërejmë se mundësitë për rritjen e kreditimit përgjatë vitit në vijim janë në përmirësim dhe se konkurrenca në rritje e sektorit do të luajë një faktor domethënës për ofertën e financimit të bizneseve.

Banka është e fokusuar në krijimin e gjithë kushteve të favorshme dhe të qasjes së nevojshme për bizneset e vogla

dhe për individët në produktet që ofron. Mbështetja me financime për segmentin e biznesit të vogël, përfshirja në projekte të veçanta për mikro ndërmarrjet dhe agrobizneset, e ka bërë bankën të rrisë praninë dhe të lidhet më shumë me bazën e gjerë të bizneseve në vend, duke ofruar edhe produkte ad hoc për nevojat e tyre dhe këshillim për angazhimet dhe projektet që ndërmarrin këto biznese. Ndërkohë, platformat digjitale që ofron banka janë përparësi në zhvillimin e mëtejshëm të marrëdhënieve të të gjithë klientelës së bankës me shërbimet e saj, duke lehtësuar qasjen dhe përfitimet për klientët, përgjatë gjithë segmenteve të shërbimeve financiare dhe jo vetëm ato bankare. Gjithashtu, ofrimi i shërbimeve jo-cash, nëpërmjet kartave të debitit dhe të kreditit, japin një mbështetje për një klientelë me kërkesa financiare në rritje, e cila mund të shfrytëzojë një sërë produktesh shtesë nëpërmjet përdorimit të këtyre mjeteve të pagesës. Fokusi në produktet financiare dhe në mjetet e pagesave online për individët është e shoqëruar me një lehtësim të qasjes në financim për nevojat e tyre. Gjithashtu, vërejmë se mbështetja ndaj klientëve tanë individë për kreditim afatgjatë për blerje shtëpie, duke vlerësuar gjendjen financiare, ngarkesën në borxhe të individëve dhe ekspozimin ndaj rrezikut të kursit të këmbimit, ka ardhur në lehtësim të kushteve të huas dhe kjo qasje do të pasqyrohet edhe në ecurinë e disbursimeve, përgjatë vitit në vijim.

Oferta me Kreditë Konsumatore Alpha

SHTËPI ✓

PUSHIME ✓

KOMUNIKIM ✓

Klientë me parapagesë
Paketa 30 DITORE VODAFONE Z

Klientë me kontratë
10 GB
NË MUAJ

Deri në **1 vit**

**PLOTËSONI
ÇDO
DËSHIRË!**


- **Këste të ulëta** mujore
- Afat ripagimi **deri në 7 vjet**
- **Pa kolateral**
- **Komunikim FALAS**

Kjo ofertë përmban terma dhe kushte. Oferta është e vlefshme nga 01.11.2018 - 31.01.2019



ALPHA BANK

www.alphabank.al
+355 4 2 278 542



Bozhidar TODOROV
Drejtor i Përgjithshëm
FIBank

Këndvështrimi i Fibank është i ndryshëm nga ajo që deklarohet në këtë pyetje!

Gjatë viteve të fundit, veçanërisht në 2017-ën dhe 2018-ën, rritja e

portofolit të huas për bankën tonë ishte mbresëlënëse. Me një rritje të portofolit të huas prej më shumë se 30% për secilin prej dy viteve të fundit, FIBank ishte një nga bankat më aktive në treg. Për më tepër, po synojmë të përshpejtojmë huadhënien gjatë vitit të ardhshëm dhe të bëhemi një nga lojtarët më të rëndësishëm. Vetëm gjatë vitit 2018 kemi hapur 4 degë të reja, duke dëshmuar angazhimin tonë për t'u zgjeruar në tregun shqiptar. Kufizimet për sektorë të ndryshëm nuk ekzistojnë për FIBank. Banka jonë është fleksibël dhe e shpejtë në vlerësimin e çdo projekti të veçantë dhe e gatshme për të mbështetur çdo klient të mirë, pavarësisht sektorit ku ai vepron.

Nga ana tjetër, jemi të kujdesshëm për sa i përket cilësisë së projekteve, sepse, nëse nuk do të jetë për vitin e ardhshëm, në vitet që vijnë, ngadalësimi i

ciklit ekonomik do të jetë fakt. Sa i fortë do jetë ky ngadalësim, askush nuk mund ta parashikojë, por ai, së bashku me rritjen e pritshme të normave të interesit, do të krijojë një situatë sfiduese për bankat dhe klientët e saj. Për të kapërcyer me sukses sfida të tilla nevojitet transparencë e plotë dhe bashkëpunim me klientët - diçka që FIBank po përpiqet të përmbushë vazhdimisht.

Duke marrë parasysh shifrat e agreguara për të gjithë sektorin bankar duhen mbajtur parasysh dhe fshirjet e huave, të cilat e ulin stokun e huave. Pa efektin e tyre, rritja e kreditimit do të ishte më e lartë.

Ekonomia e Shqipërisë shënoi rritje të konsiderueshme të PBB-së, mbi 4% [4.43% T2 - 2018], por kjo nuk u përkthye në një rritje të portofolit të huave. ICB - Albania e mbylli vitin 2018 me një rritje modeste të portofolit të huave, duke pasqyruar kështu situatën aktuale në tregun shqiptar të huave, e kryesisht në segmentin NMV/Korporata. Ndërkohë që huaja konsumatore vazhdon të rritet nga viti në vit, e llogaritur si raport i huave konsumatore/PBB, ajo mbetet prapa treguesve të vendeve fqinje dhe atyre të zhvilluara. Sipas ICB Albania, një nga faktorët më të rëndësishëm në portofolin e kredisë është vendimi i qeverisë, i hyrë në fuqi gjatë vitit 2018, për pranimin nga bankat vetëm të pasqyrave financiare zyrtare nga bizneset, gjë që ka penguar rritjen e këtij segmenti, ku ndikimi është më i dukshëm gjatë dy tremujorëve të fundit.

Si faktor i dytë mund të përmendet "shtrëngimi i kushteve të kredisë, për të zvogëluar rrezikun". Ky faktor nuk duhet të nënvlerësohet, pasi është një faktor i brendshëm i rëndësishëm, që po aplikohet aktualisht nga bankat. Gjithashtu, ai po shoqërohet dhe me fshirjet e huave nga bilancet e bankave, duke reduktuar kështu bilancin e mbetur të portofolit total të tregut.

Një tjetër arsye madhore për këtë stanjacion është mungesa e gatishmërisë për investime, përgjatë gjithë industrive kryesore, me përjashtim ndoshta të sektorit të hotelieri - turizmit.

Lidhur me perspektivën, vlerësohet se sektori i hotelieri - turizmit do të ketë kërkesë të vazhdueshme për hua, pasi kjo lidhet drejtpërdrejt me rritjen vjetore të turizmit, e cila është reale. Sigurisht që do të jetë kritike për qeverinë të vazhdojë ta mbështesë këtë zhvillim



Gideon VAN DEN BROEK
Drejtor i Përgjithshëm
ICB ALBANIA

pozitiv. Për herë të parë, eksportet "Made in Albania" kanë tejkaluar 50% të importeve dhe kjo prirje është premtuese. Kreditimi i shoqërive eksportuese do të kontribuojë në rritjen e huas.

Megjithë mundësitë që ekzistojnë për investime, për shembull, në energjinë e rinovueshme - sidomos atë diellore, vonesat në procedurat administrative po i dekurajojnë investuesit potencialë, duke bërë që ata të zhvendosin fokusin e tyre drejt vendeve të tjera të Ballkanit.

Projektet e mëdha infrastrukturore, në proces dhe ato të planifikuara për vitet e ardhshme, duhet të japin një impuls për industrinë e lidhura me to, si dhe mund të rrisin kërkesën për hua. Këtu është e rëndësishme që të rriten transparencat dhe lehtësitë e të bërit biznes, me mbështetje dhe nga

qeveria, pasi kjo do të hapë tregun për më shumë biznese, në vend të ekzistencës në treg të një numri të vogël lojtarësh.

Viti 2019 do të ndjekë një prirje të ngjashme me vitin e kaluar, ku nuk pritet një përsheptim i madh i tregut të huave.



Adela LEKA

Drejtuuese e Drejtorisë Ekzekutive
PROCREDIT BANK ALBANIA

Faktorët kryesorë që ndikojnë në stanjacionin e përgjithshëm të kreditimit lidhen me mjedisin ligjor dinamik në treg, kur bëhet fjalë për formalizimin e ekonomisë, ndryshimet në bazën rregullatore bankare, normat e ulëta të interesit për huat dhe struktura e përgjithshme e tregut të NVM-ve.

Mjedisi ligjor, pavarësisht faktit se nuk ka ndryshime të rëndësishme rregullatore, kanë krijuar një perspektivë të paqartë për NVM-të, të cilat ishin të papërgatitura për t'iu përgjigjur zbatimit të masave kundra informalitetit. Mungesa e njohurive financiare dhe mungesa e njohurive mbi kërkesat fiskale ka krijuar një mjedis ku NVM-të duhet të përshtaten dhe, në të njëjtën

kohë, i kanë shtyrë investimet e planifikuara në një të ardhme të afërt, kur ato mendojnë se do të ndihen të sigurt në përmbushjen e kërkesave fiskale. Fokusi i rregullatorëve në procesin e de-euroizimit, aplikimi i pasqyrave financiare zyrtare (tatimore) për të aplikuar për hua, zbatimi i ICAAP (Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Kapitalit), LCAAP (Procesi i Vlerësimit të Brendshëm të Mjaftueshmërisë së Likuiditetit) dhe planet e shpëtimit kanë bërë bankat t'i përqendrojnë burimet në përmbushjen e këtyre kërkesave. Nga ana tjetër, bankat duhet t'i marrin vendimet e tyre në kuadër të një mjedisi me norma të interesit shumë të ulëta dhe ndryshime në bazën rregullatore, të cilat janë me shumë kosto. Niveli i perceptimit të rrezikut për tregun, në një mjedis të tillë, është ende i moderuar, ndërkohë që normat e ulëta të interesit nuk pasqyrojnë rrezikun në një perspektivë të tillë. E fundit, por jo më pak e rëndësishme, struktura e tregut të NVM-ve karakterizohet nga një numër i kufizuar i shoqërive të mëdha dhe një numër i madh mikro ndërmarrjesh. Shoqëritë e rregullta dhe të mëdha duket se janë në fokus të bankave, pasi ato perceptohen si më të qëndrueshme dhe më pak të rrezikshme, ndërkohë që ndërmarrjet e vogla janë me shumë kosto, kur bëhet fjalë për financimin e tyre.

Periodha e tranzicionit drejt

një ekonomie më formale dhe një mjedisi ligjor të qëndrueshëm do të duhet të përfundojë së shpejti dhe perspektivat për vitin 2019 mbeten pozitive. Arsytet kryesore për një vlerësim të tillë bazohen në kohën që tregu ka të nevojshme për t'u përshtatur me ndryshimet dhe që të harmonizojë modelet e biznesit me mjedisin ligjor. Struktura e NVM-ve dhe normat e ulëta të interesit do të vijojnë ende të sfidojnë sektorin bankar, për një periudhë më të gjatë kohe.

Gjatë vitit 2018, ProCredit Bank Albania u fokusua në financimin e NVM-ve që veprojnë kryesisht në prodhim, ku portofoli i përgjithshëm i huas u rrit me 10%. Gjithashtu, fokusi i lartë në investimet e Gjelbra ka prodhuar rezultate shumë të mira, ku rritja e Portofolit të Gjelbër ishte 36%, krahasuar me vitin 2017. Në vitin 2019, fokusi ynë kryesor do të jetë në NVM-të që operojnë në industrinë e prodhimit dhe përpunimit, e që dëshirojnë të investojnë në teknologji moderne dhe në masat lidhur me Eficiencën e Energjisë. Bazuar në potencialin e vendit tonë, ekspertizën tonë dhe përmirësimet në bazën rregullatore, një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet projekteve të energjisë së rinovueshme, si: impiantet fotovoltaike, duke përmbushur në këtë mënyrë qëllimin tonë për të mbështetur klientët në uljen e kostove operacionale dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg.



Silvio PEDRAZZI

Drejtor i Përgjithshëm
INTESA SANPAOLO BANK ALBANIA

Diskutimi mbi kredinë për ekonominë nuk duhet të kufizohet vetëm në aspektin e “Totalit të Portofolit të Huas” në Shqipëri, por këtu këshillohet dhe duhet bërë një analizë më e thellë. Lidhur me shifrat e vitit 2018 për kredinë për ekonominë, mendoj se duhet të kihet parasysh disa prirje strukturore dhe ngjarje të jashtëzakonshme.

Për sa i përket prirjeve strukturore, ato kanë të bëjnë me rritjen e qëndrueshme të portofolit të huas për segmentin “Individë dhe NVM”, ndërsa segmenti “Korporata” po e zvogëlon “oreksin” për huamarrje; kjo prirje mund të konsiderohet si një përafrim dhe ripozicionim normal dhe i ngjashëm me situatën edhe në vendet e tjera fqinje, ku segmenti “Individë” përbën pjesën më të madhe të portofolit të huas.

Lidhur me ngjarjet e jashtëzakonshme, do dëshiroja të theksoja se, gjatë vitit të kaluar, u bëmë dëshmitarë të: (i) rifinancimit të ekspozimeve në shifra të mëdha (private dhe publike vendase) nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare; (ii) zvogëlimin

të konsiderueshëm të huave me probleme; (iii) mbiçmimit të fortë të monedhës vendase kundrejt euros dhe dollarit amerikan (që solli uljen e stokut të totalit të huas, që raportohet gjithmonë në lekë); (iv) ndryshimeve përkatëse në strukturën e pronësisë së disa bankave shqiptare. Të gjithë këta faktorë kanë ndikuar në sasinë e totalit të portofolit të huave dhe ka gjasa që, edhe gjatë vitit 2019, do të vijojë efekti ndikues i strategjive aktuale të bankave individuale.

Në fakt, situatat e sipërpërmendura mund të konsiderohen vërtet pozitive e që po i hapin rrugën një rritjeje më të qëndrueshme dhe organike në të ardhmen e afërt. Sa i përket Intesa Sanpaolo Bank Albania dëshiroj të theksoj se, shumica e huave të reja, të disbursuara gjatë vitit 2018, ishte shumë më e lartë, krahasuar me vitin e mëparshëm, duke i dhënë shtytje investimeve të reja në ekonominë

shqiptare.

Lidhur me parashikimet për vitin 2019, duke supozuar se ekonomia do vazhdojë të rritet sipas parashikimeve dhe në një mjedis të qëndrueshëm shoqëror, personalisht pres një rritje të mëtijshme të kredive konsumatore dhe atyre hipotekare, ndërsa segmenti i NVM-ve dhe korporatave ka ende hapësira të mëdha për t’u shfrytëzuar, sidomos në sektorë të tillë si: energjia, turizmi dhe shërbimet. Konkretisht, rritja e dukshme në fluksin e turistëve do të krijojë biznese të reja, jo vetëm lidhur me ndërtimin e objekteve turistike (që përbën një prirje tashmë të konsoliduar), por edhe në veprimtaritë e tjera ndihmëse të saj. Të gjitha parakushtet makroekonomike janë në parametra optimale (përfshirë dhe nivelin e ulët të normave të interesit), kështu që jam shumë i sigurt se do të kemi një rritje të fortë të veprimtarisë huadhënëse.



Christian CANACARIS

Drejtor i Përgjithshëm
RAIFFEISEN BANK ALBANIA

Nëse flasim për një stanjacion të kreditimit gjatë vitit 2018, atë mund ta përcaktojmë si një konkluzion disi çorientues, pasi për të bërë një analizë të plotë,

duhet të marrim në konsideratë fshirjen e huave, si dhe faktin që BERZH-i disbursoi këstin e parë të huas për KESH, i cili iu “zbrit” sektorit bankar. Në përgjithësi, bankat në Shqipëri vazhduan të japin hua, veçanërisht në sektorin e individëve, ku ka një rritje pozitive.

Lidhur me 2019-ën, pritshmëritë janë për një rritje më të madhe të huadhënies, për shkak të rritjes pozitive të PBB-së, rritjes së kërkesës për hua, si dhe pritjet një kthesë pozitive të ngjarjeve që lidhen me pranimin në BE gjatë 2019-ës. Gjithashtu, pritjet që huaja për individë të vazhdojë të njëjtën prirje, por e njëjta gjë pritjet edhe në huadhënien për korporatat.



Bledar SHELLA

Drejtor i Përgjithshëm
SOCIETE GENERALE ALBANIA

Gjatë 15 viteve të fundit, Shqipëria ka përjetuar një cikël ulje-ngjitjesh në veprimtarinë e huadhënies. Pavarësisht se u fillua nga një bazë shumë e ulët, vendi përjetoj një rritje të madhe të huadhënies për sektorin privat, midis viteve 2004 dhe 2008, ku ritmet e rritjes së huas ishin mesatarisht 55% në vit dhe zgjerimi i portofolit të huas, me më shumë se 25 për qind. Në një farë mase, ky "boom" i huave mund t'i atribuohet procesit të përshpejtimit, lidhur me raportin hua ndaj PBB-së dhe zhvillimit financiar të vendit. Përshkallëzimi i krizës globale financiare në fund të vitit 2008 - fillim viti 2009 e goditi ekonominë shqiptare dhe sektorin bankar. Përkeqësimi i kushteve ekonomike, së bashku me gabimet e bëra nga shumë banka në huadhënien agresive të viteve të mëparshme, çuan në mospagesa të huave, duke rritur portofolin e huave me probleme.

Nga krahu i ofertës, bankat u përgjigjën duke shtrënguar standardet e huadhënies. Përtej përkeqësimit të besueshmërisë së klientëve dhe perspektivave të zymta ekonomike, u ul edhe vet kërkesa për hua. Dëmi i shkaktuar bilanceve të bankave dhe nivelit të borxhit të huamarrësve ishte aq i madh, sa edhe shumë vite pas

fillimit të rimëkëmbjes ekonomike dhe pastrimit të fundit të bilanceve të bankave, tregu i huadhënies duket të jetë ende në përpjekje për të rimarrë veten, drejt rritjes së huadhënies, duke mbetur në mënyrë të konsiderueshme i dobët.

Tashmë pastrimi i bilancit të bankave është thujse drejt fundit dhe rimëkëmbja ekonomike është stabilizuar. Megjithëse pritet që axhustimi pas krize në tregun e huave të vijojë, skenari ynë bazë është për një kthim gradual në normalitet, më shumë sesa një rritje e fortë e huadhënies. Parashikimi ynë për vitin 2019 është që rritja e huas të ecë gradualisht me një ritëm njëshifror, në përputhje me faktorët themelorë. Në fakt, evolucioni pozitiv i variablave kryesorë makroekonomikë pritet të vazhdojë, por nga ana tjetër, informaliteti është ende i lartë dhe zbatimi i ligjit apo ekzekutimi i kolateralit janë ende problematik. Ende ka pasiguri për të ardhmen nga bizneset dhe individët. Për të përmirësuar mjedisin ekonomik dhe për të rritur huadhënien, është e nevojshme të vazhdohet me reformat në zbatimin e ligjit dhe të luftohet informaliteti. Çdo vendim që synon uljen e pasigurisë dhe/ose lehtëson pritshmëritë, do të mirëpritet nga komuniteti i biznesit.

Si bankë, ne kemi qenë aktive në huadhënie gjatë viteve të fundit, duke rritur në mënyrë të qëndrueshme portofolin e huas, si për korporatat, ashtu edhe për individët, duke u bërë banka e katërt më e madhe në vend për huat ndaj korporatave dhe e treta për huat për individët. Strategjia jonë për vitin 2019 është të vazhdojmë rritjen dhe të konsolidojmë pozicionin tonë, duke intensifikuar cilësinë e marrëdhënieve me klientët tanë, qofshin ata individë, profesionistë, NMV, mikro-ndërmarrje, apo korporata të mëdha. Planet dhe pritshmëritë tona janë për një vijueshmëri të rritjes së qëndrueshme të agregatëve të përgjithshëm të sektorit bankar.



Gazmend KADRIU

Drejtor i Përgjithshëm
UNION BANK

Për sa i përket stanjacionit të kredisë për vitin 2018, shifrat aktuale zyrtare gjithmonë duhet të marrin parasysh dhe efektin e raportit të miratimeve dhe disbursimeve të reja, përkundrejt shlyerjeve normale të huave, plus efektin e fshirjes së huave. Lexuesit e Bankieri-t e kanë shumë mirë të qartë këtë fakt, por publiku i gjerë shpesh e interpreton këtë shifër si mungesa e rritjes së gjithsej portofolit të huas nënkupton se nuk jepen hua të reja dhe jo sepse thjesht disbursimet e huave të reja nuk tejkalojnë nivelin e shlyerjeve të huave ekzistuese. Megjithatë, edhe pas një analize të tillë të zgjeruar, nuk përbën surprizë të madhe fakti që huadhënia në vitin 2018 ishte më e dobët se vitet e tjera.

Mbetet shumë e vështirë që të krahasohet, për të mos folur pastaj rreth matjes nga pikëpamja sasiore, efektet e faktorëve të ndryshëm që mund të kenë kontribuar në këtë drejtim. Disa nga faktorët mund të jenë: veprimtaria e shëndoshë e biznesit nga vet agjentët ekonomikë, të cilët nuk kanë shumë nevojë për

hua, siç është rritja e dukshme e veprimtarisë së ndërtimit pa një rritje korresponduese të huas për ndërtim; hyrjet e mëdha të euros, që kanë sjellë një mbiçmim të lekur në nivele historike. Një faktor tjetër mund të jetë orientimi i bankave drejt huadhënies bazuar vetëm në pasqyrat financiare zyrtare, të cilat mund të kenë ndërprerë qasjen në hua për një numër të konsiderueshëm biznesesh më të vogla ose dhe jo aq të vogla me pasqyra financiare zyrtare të dobëta. Përfundimisht, një faktor i rëndësishëm është dhe procesi i vazhdueshëm i konsolidimit në sektorin bankar, i cili përfshiu

rreth gjysmën e sektorit bankar. Procese të tilla normalisht ndikojnë drejtpërdrejt në huadhënie, si për bankat që po shiten, ashtu dhe për bankat që i blejnë ato. Në një numër rastesh, bankat e tjera që nuk janë përfshirë në veprimtari të tilla të shkrirjeve dhe bashkimeve, mund të mos jenë në gjendje ta kompensojnë plotësisht këtë efekt rënës.

Rritja e huas në vitin 2019 do të ndikohet drejtpërdrejt nga ndërveprimi i faktorëve të mësipërm, si dhe nga çdo faktor tjetër. Për shembull, parashikimet për rritjen ekonomike janë inkurajuese në këtë aspekt, pasi ato duhet të çojnë

në një rritje të numrit dhe cilësisë së interesit të aplikimeve për hua (edhe pse ndonjëherë jo aq shumë, siç u përmend më sipër, sa i përket sektorit të ndërtimit). Në presim gjithashtu një formalizim gjithnjë e më të madh, në një numër sektorësh ekonomikë. Mundësitë janë që rritja e pritshme ekonomike do të kombinohet fort me formalizimin në rritje dhe konsolidimin përfundimtar në sektorin bankar, për të prodhuar kërkesë dhe ofertë më të lartë për hua. Sipas një skenari të tillë, rritja e huas duhet të fillojë gjatë vitit 2019 dhe ajo do të përshejtohet edhe më shumë në vitet e ardhshme.

SAVE THE DATE

AAB 3rd Conference
Banks for sustainable development
14 May 2019

1999 - 2019

20

ALBANIAN ASSOCIATION OF BANKS
SHOQATA SHQIPTARE E BANKAVE

Sistemet e byrove të kredive

Sektori financiar dhe ndikimi i tyre ekonomik

Sistemet e raportimit të kredive u mundësojnë huadhënësve t'u japin kredi individëve dhe bizneseve të kualifikuara, bazuar në një analizë më të saktë rreth besueshmërisë, të shkuarës dhe të tashmes së tyre, e këto të mbështetura në informacione të sakta dhe të besueshme.



James AZIZ

Konsulent
BERZH

Byroja e Kredive është një bazë të dhënash lidhur me detajet e detyrimeve dhe modeleve të shlyerjes nga ana e huamarrësve. Huamarrësit identifikohen nga një sërë atributësh. Të dhënat e kredisë dhe identifikimit ofrohen nga bankat dhe agjencitë e tjera, që japin hua të çdo lloji. Shërbimi bazë që siguron Byroja e Kredive është që t'i ndajë këto të dhëna në dosje individuale kredish, sipas huamarrësve dhe t'i bëjë ato të disponueshme për përdoruesit e autorizuar, kundrejt një tarife. Byroja e kredive nuk miraton hua, nuk jep asnjë lloj klasifikimi të huave, e as nuk përcakton ndonjë gjendje pagese huash, në bazën përkatëse të të dhënave. Çdo gjendje pagese përcaktohet nga ofruesit e të dhënave. Byroja e Kredive zhvillon edhe produkte e shërbime të tjera, duke përdorur të informacionet e bazës së të dhënave, për të përmbushur nevojat e grupit të saj të

përdoruesve.

Byrotë private dhe regjistrat publik të kredive sigurojnë zgjerimin e sistemit financiar, duke përfshirë një numër më të madh të popullsisë së vendit. Informacioni rreth kredive që banka qendrore mund t'i ofrojë bankave e, në një kuptim më të gjerë, raportet e kredisë që mund të ofrohen në treg nga byrotë private të kredive, po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme në mbarë botën, të nxitura nga kërkesa për të dhënat që "popullojnë" bazat e tyre të të dhënave, nga ana e bankave private dhe ndërmjetësve të tjerë financiarë, si dhe nga kërkesat e firmave private, shitësve me pakicë, shoqërive të shërbimeve publike, shoqërive celulare, punëdhënësve, qiradhënësve, etj. Mbikëqyrësit dhe rregullatorët e bankave po rrisin kërkesën e tyre për të dhëna cilësore rreth kredive, për një monitorim më efektiv të rreziqeve të besueshmërisë, në institucionet financiare që ato mbikëqyrin.

Studimet tregojnë një lidhje të fortë midis shkallës së raportimit mbi kreditë në një ekonomi dhe kredisë private ndaj PBB-së. Sistemet e raportimit të kredive u mundësojnë huadhënësve t'u japin kredi individëve dhe bizneseve të kualifikuara, bazuar në një analizë më të saktë rreth besueshmërisë, të shkuarës dhe të tashmes së tyre, e këto të mbështetura në informacione të sakta dhe të besueshme. Rezultati është një kosto më e ulët huaje për huamarrësit dhe humbje më të reduktuara e kosto më të ulëta të inspektimit mbi besueshmërinë

nga ana e ofruesve të huave. Të dhënat empirike tregojnë se standardi i jetesës në vendet që kanë një lloj agjencie të raportimit të kredive, është më i lartë se në ato që nuk ka një agjenci të tillë, pasi informacioni nga çdo lloj agjencie për raportimin e kredive mbështet rritjen e tregut të huadhënies, duke rritur disponueshmërinë e huas, si dhe lejon rritjen e kufijve të huas, meqenëse huadhënësve u vihen në dispozicion më shumë të dhëna, mbi të cilat ato mund të marrin vendime më të sakta për huat që akordojnë.

Agjencitë publike dhe private më efektive të raportimit të kredive japin informacione pozitive dhe negative mbi besueshmërinë, me qëllim që t'u mundësojë huamarrësve, që i respektojnë përgjegjësitë e huamarrjes, të krijojnë "kolateral reputacional", por dhe të paraqesin ata që nuk i përmbushin detyrimet. Kostot e shqyrtimit dhe inspektimit të aplikimit për hua zvogëlohen, duke pasur parasysh gjithë përfshirjen dhe thellësinë e të dhënave që gjenden pranë agjencisë së raportimit të kredive, ndërkohë që huadhënësit janë më pak të preokupuar nga fakti i mos-deklarimit të paaftësisë paguese të kërkuarit të huas, meqenëse ekziston një bazë të dhënash qendrore, ku mund të kontrollohen dhe zbulohen borxhet e padeklaruara. Për rrjedhojë, përbindja e publikut që ka qasje në hua, në vendet që kanë një ose më shumë agjenci për raportimin e kredive, është shumë më e madhe se sa në vendet që nuk i kanë regjistra të tillë.

Agjencitë publike ose private të raportimit të kreditit janë të ndryshme, në vende të ndryshme. Në shumë juridiksione legjislativi e kufizon ndarjen e informacionit, ndërsa diku tjetër legjislativi lejon këtë ndarje të informacionit, ndërkohë që mbron të drejtat e individëve, informacioni rreth të cilëve shpërndahet nga përdoruesit e autorizuar. Ndërkohë, është ndërmarrë një studim se pse disa vende zgjedhin një regjistrat publik të kredive, nën administrimin e Bankës Qendrore, ndërsa vende të tjera zgjedhin një byro private, sikundër ka dhe vende të tjera që i kanë të dyja. Përfundimi themelor është se nuk ka ndonjë model për t'u ndjekur, ose arsye të qartë për këtë zgjedhje.

Në rajonin e Ballkanit dhe më gjerë, ekzistojnë të gjithë modelet: vetëm regjistra publik të kredisë, vetëm byro private të kredisë, si dhe byro publike dhe private të kredisë: Italia (publike dhe private), Greqia (private), Mali i Zi (publike), Kosova (publike), Turqia (publike dhe private), Kroacia (private), Serbia (publike), Bullgaria (publike), Maqedonia (publike dhe private), Ukraina (publike dhe private), Egjipti (publike dhe private), Sudani (publike). Bashkëpunimi ka kuptim kur ekzistojnë si regjistrat publikë, ashtu dhe byrotë private të kredisë. Nga pikëpamja ligjore, në botë nuk ka vende që kanë legjislacion dhe/ose kuadër ligjor të ngjashëm, lidhur me industrinë e raportimit të kredive. Kuadri ligjor është një zgjidhje në rrafsh kombëtar, që plotëson nevojat dhe interesat e tregut të brendshëm dhe Shqipëria nuk bën përjashtim nga ky rregull. Ajo çka është e vërtetë është fakti që, të gjitha vendet me byro private të kredisë kanë një lloj legjislacioni/bazë rregullatore që mirë përcakton veprimtarinë e këtyre byrove të kredisë dhe u siguron të drejta dhe mbrojtje individëve, për sa i përket

të dhënave personale të kredive dhe atyre demografike, që mbahen në një byro private të kredive.

Në Shqipëri, përpjekjet për krijimin e një byroje private të kredisë filluan në vitin 1998, por për shumë arsye, kjo përpjekje nuk pati sukses. Në vitin 2006 angazhohet Banka e Shqipërisë ku dhe me ndihmën teknike nga FMN, filluan përpjekjet që çuan në krijimin e regjistrat të kredive të Bankës së Shqipërisë (RKBSH), në janar të 2008-ës. Gjatë 10 viteve të fundit RKBSH ka qenë në dispozicion për subjektet e licencuara nga Banka e Shqipërisë. Këto subjekte të licencuara janë të detyruara të ofrojnë të dhënat e tyre të RKBSH mbi baza mujore, ndërkohë që janë të autorizuar të kërkojnë dosjet e kredisë, lidhur aplikimet e huamarrësve. Institucionet e tjera jo-banka, shoqëritë e telekomunikacionit, etj., nuk kanë qasje në RKBSH.

Aktualisht, bankat përmes Shoqatës Shqiptare të Bankave, po kërkojnë mundësinë e krijimit të një byroje private të kredive në Shqipëri. Konceptualisht, një byro shqiptare e kredive do të rrisë me dy herë të dhënat e kredive për huamarrësit se sa ato aktuale në RKBSH dhe shton mbi 500,000 dosje kredish. Byroja e kredive mund të shtojë produkte të reja, të tilla si: pikëzimi i përgjithshëm i kredisë, bazë të dhënash për mashtimet, qasje përmes VPN-ve, lejimi i përpunimit të të dhënave në grup, krijimi i një sërë raporteve për kreditë, ofrimi i mjeteve të marketingut të kredisë, qasje nëpërmjet celularit, mbrojtje të të dhënave të huamarrësve, ofrimi i njoftimeve të kujdesit, avancime teknike të fjalës së fundit, që mund të jenë vlefshme për analiza, si dhe sugjerime për produkte ose shërbime të tjera, të propozuara nga përdoruesit e saj.

Çfarë nënkupton byroja e kredive për komunitetin e bankave në Shqipëri

1. Të dhëna më të hollësishme mbi kreditë nga shoqëritë e shërbimeve publike, telekomunikacionit, shoqëritë e faktoringut dhe huadhënësit e tjerë të çdo lloji;
2. Zgjerim i numrit të dosjeve të kredive të huamarrësve – mundësi për rritjen e numrit të dosjeve të kredive të huamarrësve me 50% më shumë se sa numri aktual i dosjeve të kredive;
3. Shtim i të dhënave nga regjistrat publikë - regjistri i pasurive të paluajtshme, regjistri i kolateraleve, regjistri i ndërmarrjeve, baza e të dhënave të falimentimeve, regjistrat e gjykatave, etj.
4. Disponim i një shumëllojshmërie produktesh dhe shërbimesh – pikëzimi i huave, zbulimi i mashtimeve, ndihma për vjedhje të identitetit, njoftime për huamarrësit, lloje të ndryshme raportesh të kredisë, njoftime për informacion negativ, monitorim të llogarisë, kërkime për debitorët që nuk gjenden, kërkime për kolaterale, shërbimet e regjistrimit, asistencë për marketing për portofolet e huave në rritje;
5. Funkcionalitet i përmirësuar teknik – ofrimi i qasjes së sistemeve për sisteme, qasje nëpërmjet VPN-ve, kërkesa në grup për raporte kredish, zgjidhje për versione në celular;
6. Shërbim klienti që trajton nevojat e klientit dhe që bashkëpunon me klientët, për të zhvilluar produkte dhe shërbime;
7. Mbrojtje të fuqishme për të drejtat e huamarrësit.

BËHU EDHE MË I ZGJUAR ME SHËRBIMET MË TË FUNDIT NGA BKT SMART!




Shërbimet e reja të BKT Smart:

- Paguaj faturat me QR Code
- Shërbimi merr rradhë
- Kliko mbi njoftimin për “Ndaje në këste”



Shkarkoje në



Vazhdon...

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE



4 22 66 288 | www.bkt.com.al

Qasja në financim për Ndërmarrjet e Mesme të Vogla dhe Mikro në Shqipëri

Kapaciteti i institucioneve publike për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqi mbetet i ulët, gjë që në fund të fundit e shtyn sektorin privat larg eksperimentimit të produkteve dhe qasjeve të reja për financim dhe një arsye e mundshme për këtë është fakti se nuk ekziston një strukturë koordinuese e organizuar, transparente dhe e përgjegjshme për grupet e interesit, lidhur me qasjen në veprimtari financimi, përgjatë gjithë sektorëve kryesorë të ekonomisë.



Keler GJIKA

Specialist i Sektorit Financiar
Departamenti i Financë, Konkurrueshmëri
& Inovacion
GRUPI I BANKËS BOTËRORE

Ndërmarrjet e Mesme, të Vogla dhe Mikro (NMVM-të) në Shqipëri janë kontribues të rëndësishëm në ekonomi. Ato¹ përbëjnë rreth 99.9% të ndërmarrjeve aktive dhe 81.9% të numrit të përgjithshëm të të punësuarve. Vetëm 17% e NMVM -ve besojnë se nuk ka pengesa për sigurimin e financimit, një numër ky dukshëm më i ulët se në ekonomitë e tjera të marra në krahasim². Ky sektor është i ngarkuar me problematika që lidhen me ekonominë gri të kudondodhur, që pasqyrohet në një numër të madh biznesesh joformale (sidomos në bujqësi), prirjes për të mos deklaruar tatimet, ose për të regjistruar

punonjësit, mbajtjen e balanceve të dyfishta, vlerën e ulët të kolateralit tashmë të rrallë, nivel i ulët i pranimit të transaksioneve digjitale dhe nivel relativisht i ulët i aftësive financiare në nivel të NMVM-së.

Gjithashtu, ekzistojnë inefficiencia edhe në krahun e ofertës. Tregu dominohet nga bankat, të cilat karakterizohen nga nivele të larta likuiditeti, kundërshtim i fortë ndaj rrezikut, i shtuar ky kryesisht pas krizës së fundit të huave me probleme dhe mungesës së stimujve të duhur për të shqyrtuar qasje të reja për financim. Një pozitë e tillë nuk ndihmohet as nga zbatueshmëria e dobët e ligjit, tregu i cekët dytësor për kolaterale dhe kujdesi nga afër disi jo-fleksibël ndaj klientëve dhe kërkesat për dokumente, që kërkohen nga Qeveria dhe Banka e Shqipërisë.

Huadhënia bazohet kryesisht në produkte të thjeshta tradicionale, ku shumica e NMVM-ve përdorin instrumentet e linjave të kredisë. Produkte të tjera janë të pazhvilluara:

- **Financimi mbi bazën e llogarive të arkëtueshme** praktikohet shumë rrallë, pasi institucionet financiare duket se nuk e kuptojnë plotësisht këtë produkt. Ekziston një besim i pakët në respektimin e të drejtave të kreditorëve, mungesë e sistemit të faturimit elektronik dhe mungesë e një regjistri për faturat digjitale.

- **Qiraja financiare** është e kufizuar kryesisht për mjetet motorike dhe

duket se ka mungesë qartësie nëse shoqëritë duhet të aplikojnë për shtesë licence, për të ofruar shërbime të qirasë operative. Tregu dytësor i dobët për pajisjet (aktivet) e rimarra në pronësi dhe pamundësia e shoqërive të qirasë për të njohur humbjet mbi bazën e provizionimit për aktivet e zhvlerësuar janë pengesa të rëndësishme për zhvillimin e qirasë.

- **Penetrimi i huas digjitale dhe i shërbimeve financiare digjitale** është shumë i ulët, gjë që minon mundësinë për të reduktuar asimetrinë e informacionit, duke mbledhur dhe përpunuar të dhëna alternative (të pagesave), ulur kostot e transaksioneve, duke ulur varësinë nga cash-i dhe duke rritur në finale të ardhurat tatimore, përmes një transparence më të madhe në treg. Edhe pse bankat kanë filluar së fundi të investojnë më shumë në kanalet digjitale (kryesisht në bankingun nëpërmjet internetit) dhe shërbimet POS po bëhen gjithnjë e më të arritshme, niveli i inovacionit dhe pranimi i pagesave digjitale është ende shumë i ulët. Kjo kryesisht për shkak të kostove të larta të shërbimeve të POS-eve, mungesës së konkurrentëve që mund të nxisin lojtarët në vend drejt novacionit, disponimi i tyre në zonat rurale dhe kultura e përgjithshme e përdorimit të cash-it.

Rrjedhimisht, financimi përmes kanaleve zyrtare i NMVM-ve në

¹ Sipas përcaktimit ligjor në Shqipëri, i cili dallon paksa nga ai që përdoret në Bashkimin Evropian.

² Komisioni Evropian, Vrojtimit mbi qasjen e ndërmarrjeve në financim – Raport Analitik 2017

Shqipëri është i ulët. Në vitin 2017, 15% e NMVM-ve përdorën fondet e pronarëve, ose fondet nga familjarët dhe miqtë, për të financuar veprimtaritë e tyre dhe 24% ripërdorën fitimet e pashpërndara.

së plotë të kapitalit njerëzor vendas, të trajnuar dhe të shpërndarë nëpër agjenci të ndryshme. Përveç nismave politike të ndryshme, në treg ofrohen shumë modele financimi të NMVM-ve, që ndryshojnë në madhësi,

financimin e kapitalit qarkullues dhe për të përmirësuar likuiditetin e pagesave në vend, qeveria mund të konsiderojë përdorimin e llogarive të pagueshme të sektorit publik, që të ofrohen për shitje në platformat e bazuara në internet. Këtu mund të mbështetet ngritja e një sistemi faturimi elektronik, i bazuar në një regjistër elektronik dhe të lidhur me autoritetin tatimor. Gjithashtu, nevojitet një reformë e regjistrimit të barrave sigurorese, për ta bërë atë online dhe të aksesueshëm në kohë reale, duke rishikuar në të njëjtën kohë nevojën, tarifat dhe rolin që luajnë noterët në procesin e kontraktimit, me qëllim uljen e kostos së huadhënies. Këtu mund të shihet mundësia për një studim fizibiliteti për krijimin e platformave elektronike rajonale, për shkëmbimin/shitjen midis huadhënësve të kolateraleve të rimarra, për të rritur efikasitetin e ekzekutimit të kolateralit dhe vlerën e tij të perceptuar. Qeveria mund të mbështesë zhvillimin e produkteve të sigurimit në bujqësi, për të rritur disponueshmërinë e financimeve për bujqësinë. Kjo mund të bëhet duke riorganizuar veprimtarinë e donatorëve në këtë drejtim, subvencionimin e primeve dhe organizimin e ngritjes së kapaciteteve nga krahu i ofertës dhe kërkesës.

Për të rritur përdorimin e pagesave elektronike, duhet që autoritetet dhe grupet e tjera të interesit të rrisin vetëdijen mes NMVM-ve për potencialin që ka tregtia elektronike (sidomos në tregti dhe turizëm), si dhe duhet të konsiderojnë futjen e pagesave me etiketë të bardhë POS/QR, për uljen e kostove të transaksioneve. Gjithashtu, duhet të synohet financimi me grante i start-up-eve të reja novatore dhe komuniteti i donatorëve duhet të ftohet që të kontribuojë në zhvillimin e kulturës së krijimit të start-up-eve në përgjithësi.

Tabela 1: Përmbledhje e financimit të NMVM-ve në Shqipëri dhe në ekonomitë e krahasueshme

Lloji i financimit të përdorur nga NMVM	% e NMVM Shqipëri	% e NMVM BE 28	% e NMVM Maqedoni	% e NMVM Serbi	% e NMVM Mali i Zi	% e NMVM Bullgari	% e NMVM Kroaci
Fonde të pronarit dhe miqve të familjes	15	8	2	5	7	5	5
Fitimi i pashpërndarë	24	15	7	14	6	14	18
Kredi me kufi (linja kredie)	29	35	34	26	19	32	23
Hua të kolateralizuara me afat të gjatë për qëllime investimi	14	17	20	19	23	12	15
Qira	4	24	8	9	5	20	18
Faktoring	2	6		4	5	1	5
NMV-të që besojnë se nuk ka pengesa për sigurimin e financimit	17	47	40	33	31	49	28

Burimi: Komisioni Evropian, Vrojtim mbi qasjen e ndërmarrjeve në financim – Raport Analitik 2017

Ndër vite janë ndërmarrë shumë reforma pozitive rregullatorë, për të përmirësuar qasjen në financim, por zbatimi i tyre, në përgjithësi, nuk ka ecur siç duhet. Kapaciteti i institucioneve publike për zbatimin e ligjeve dhe rregulloreve në fuqimbetet i ulët, gjë që, në fund të fundit, e shtyn sektorin privat larg eksperimentimit të produkteve dhe qasjeve të reja për financim. Një arsye e mundshme për këtë është fakti se nuk ekziston një strukturë koordinuese e organizuar, transparente dhe e përgjegjshme për grupet e interesit, lidhur me qasjen në veprimtari financimi, përgjatë gjithë sektorëve kryesorë të ekonomisë. Kjo rezulton në ofrimin e qasjeve të pjesshme dhe të segmentuara të NMVM-ve në zhvillimin e financimeve, kryesisht të bazuara në projekte donatorësh, si dhe në mungesën e panoramës

kushtet e financimit dhe prioritetet që kanë. Megjithatë, disa prej këtyre fondeve financuese ose janë shumë të vogla, me kritere shumë të rrepta kualifikuese, ose nuk janë të koordinuara për të synuar zhvillimin e sektorëve të veçantë, modeleve të caktuar të biznesit, apo fazave të ndryshme të zhvillimit të shoqërive, në përputhje me objektivat e zhvillimit të vet qeverisë.

Për të trajtuar këto çështje, autoritetet mund të ndërmarrin një sërë hapash për të përmirësuar qasjen në financim për NMVM-të. Në fillim, duhet të zhvillohet një strukturë koordinuese e zhvillimit të NMVM-ve dhe një strategji gjithëpërfshirëse e zhvillimit të NMVM-ve, nëpërmjet zhvillimit të një plani veprimi me prioritet, në nivel të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

Për të mbështetur qasjen në

Financimi i një rritjeje të qëndrueshme në vendet e Ballkanit Perëndimor

Roli dhe rëndësia e bankave

Si ndërmjetëse, bankat kanë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh moderne, nisur nga pagesat dhe shërbimet e pagesave, mbështetja për eksportet, financimi i kërkesës së shoqërive të mëdha, menaxhimi i rrezikut deri te pjesëmarrja në tregjet e kapitaleve.



Dr. Stadjana SREDOJEVIC

Këshilltare speciale për bashkëpunimin ndërkombëtar, edukimin dhe tregjet financiare

Drejtuuese e Qendrës së Trajnimeve Bankare SHOQATA E BANKAVE TË SERBISË

Nisur nga hendeku i investimeve në Bashkimin Evropian, që vlerësohet rreth 700 miliardë Euro në vit, ka qenë mëse e dëshirueshme përfshirja e sektorit financiar në mbështetje të një rritje ekonomike dinamike dhe të qëndrueshme, novacioneve dhe investimeve afatgjata, duke ruajtur sigurinë dhe stabilitetin e arritur. Rëndësia e financimit privat të ekonomisë, gjithashtu, formulohet në paradigmen e quajtur Financimi i Rritjes. Bashkimi Bankar dhe Bashkimi i Tregjeve të Kapitalit, janë projekte të rëndësishme

strategjike të Bashkimit Evropian, të cilat synojnë të sigurojnë integrim



Bankat që operojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, edhe pse jashtë BE-së, mund të ofrojnë ekspertizë dhe kapacitete financiare, njerëzore, si dhe kapacitete të tjera, për realizimin e modelit të rritjes së ekonomisë në tregun e brendshëm. Për shkak të kapacitetit të tyre të përgjithshëm, ato mund të përfaqësojnë një partner të rëndësishëm dhe ndoshta kyç në financimin e një rritjeje të qëndrueshme në ekonominë e tyre përkatëse, të cilat po përballen me nevojat të mëdha zhvillimi dhe me kufizime serioze në buxhet.



të plotë të tregjeve financiare, mundësi të forta huadhënie dhe efekt multiplikator të madh. Kjo do të sillte diversifikim të burimeve

për financimin e rritjes, i cili është objektivi final i zhvillimit të tregjeve të kapitaleve në BE. Si rrjedhim, është e kuptueshme se roli i bankave sot është shumë i rëndësishëm për politikëbërësit, jo vetëm si partnerë në fushën e rregullimit dhe politikave, por edhe si aktor kryesor në tregjet financiare, për të ofruar financim privat të objektivave ekonomike/publike.

Nevojat për zhvillim, si një mundësi për rajonin e Ballkanit Perëndimor

Edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor ekziston e njëjta nevojë për financimin e ekonomisë. Nevoja e përgjithshme për investime mbetet ende e lartë dhe mungesa kapaciteteve infrastrukturore dhe investimeve është veçanërisht më e dukshme në sektorët e infrastrukturës, të tillë si: përpunimi i mbeturinave, furnizimi me ujë, shëndetësia, arsimit, etj. Megjithëse ka mjaft nisma financiare në rajon (Kuadri Evropian i Investimeve në Ballkanin Perëndimor - WBIF, nisma kineze "Një Brez, Një Rrugë" - BRI, Nisma Evropiane për Projekte të Ekonomisë së Gjelbër, etj.) dhe kur kushtet financiare janë në përmirësim, rajoni i Ballkanit Perëndimor karakterizohet kryesisht nga:

A) Nevoja të larta për zhvillim. Sipas një studimi¹ të publikuar

¹ Investimi në vendet e Ballkanit Perëndimor: Drejtimet dhe kufizimet e reja financiare në investimet në infrastrukturë, Mario Holzner dhe Richard Grieveson (Nëntor 2018). Vjenë: Instituti i Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare.

kohët e fundit mbi investimet në Ballkanin Perëndimor, kufiri i poshtëm i vlerësimit të nevojave për investime shtesë, vetëm në investimet alternative të infrastrukturës, për pesë vitet e ardhshme, është rreth 800 milionë euro. Gjithashtu, Raporti i BERZH-it për Tranzicionin 2017-18 vlerësoi se nevojat vjetore për investime në infrastrukturë, për periudhën 2018-2022 janë veçanërisht të larta në Ballkanin Perëndimor, me Bosnjë – Hercegovinë, Shqipëri dhe Malin e Zi. Përveç kësaj, BERZH vlerëson se nevoja vjetore për investime në infrastrukturë luhatet në intervalin 8% deri 12% të PBB-së, me qëllim që të realizohen investimet me hapa gjigande (në nivelet e infrastrukturës, tipike për vendet e zhvilluara), si dhe zëvendësimi dhe mirëmbajtja². Duke pasur parasysh se në vendet e rajonit investimet në infrastrukturë janë rreth 1% të PBB-së, vërehet se hendeku në infrastrukturë është mjaft i madh.

B) Huamarrja sovraane. Aktualisht, nivelet e borxhit të jashtëm janë rritur ndjeshëm, veçanërisht pas shpërthimit të krizës financiare, gjë që përbën pengesë për financimin e mëtejshëm tradicional (të bazuar në hua) të investimeve dhe rritjes. Kjo paraqet një sfidë serioze për sektorin publik, që synon të realizojë investime kapitale të mëtejshme dhe përmbushë kërkesat e zhvillimit.

Prandaj, si dhe në rastin e BE-së, në rajonin e Ballkanit Perëndimor ka një ndërgjegjësim gjithnjë e më të madh për nevojën e përfshirjes së financimit privat, ku bankat tregtare luajnë një rol vendimtar.

Roli dhe rëndësia e bankave në financimin e rritjes së qëndrueshme

Siç u përmend më parë, brenda

vizionit të një kontributi afatgjatë për ekonominë dhe për përbalimin e sfidave ekonomike, sociale dhe politike të kohës sonë, bankat luajnë sot një rol udhëheqës në financimin e zhvillimit. Rëndësia e tyre në modelin e rritjes nënkupton më shumë segmente:

- Si ndërmjetëse, bankat kanë një rol gjithnjë e më të rëndësishëm, duke ofruar një gamë të gjerë shërbimesh moderne, nisur nga pagesat dhe shërbimet e pagesave, mbështetja për eksportet, financimi i kërkesës së shoqërive të mëdha, menaxhimi i rrezikut deri te pjesëmarrja në tregjet e kapitaleve.

- Roli në rritje i bankave në financimin e rritjes ekonomike mobilizon sasi të konsiderueshme të kursimeve të akumuluar nga investuesit (duke përfshirë investuesit individual), të cilat kërkojnë një kuadër të qëndrueshëm të mbrojtjes së investuesve, lirinë

e zgjedhjes së një produkti të tregtueshëm të përshtatshëm (sipas kërkesës), si dhe edukimin financiar të investuesve.

- Bankat janë tashmë burimi më i rëndësishëm i financimit për zhvillimin e shoqërive evropiane; anketa më e fundit e investimeve nga EIB (EIBIS), pohon se financimi bankar përbën rreth 70% të burimeve të jashtme të tyre. Përveç rëndësisë së tyre aktuale, po lehtësohet qasja në financim për klientë të rinj potencialë, veçanërisht për NMV-të.

- Financimi i rritjes ndikon gjithashtu biznesin, modelin organizativ dhe kulturën e vet biznesit bankar. Ky i fundit, në marrëdhënie biznesi me ekonominë dhe me popullsinë, fokusin e vendos në cilësinë dhe qëndrueshmërinë e marrëdhënieve me klientët, kundrejt transaksioneve individuale (të orientuara nga



² Raporti i BERZH-it për Tranzicionin 2017-18 (2017). Londër: BERZH.

cilësia e marrëdhënies përkundrejt orientimit nga marrëveshja).

- Rëndësia në rritje për investime të qëndrueshme, ekologjike dhe të përgjegjshme nga pikëpamja sociale, si dhe koncepti i ekonomisë qarkulluese, i lejon bankat që, përveç nismave tradicionale, të zhvillojnë teknika dhe fusha të reja financimi dhe të bëhen partner i rëndësishëm për sektorin publik, në arritjen e objektivave ekonomike. Obligacionet e gjelbra, obligacionet me ndikim në zhvillim, Partneritetet Publik - Privat, koncesionet, janë disa nga modelet që mund të përdoren në rajonin e Ballkanit Perëndimor

Përfundimisht, të dhënat dhe vitet e fundit tregojnë se në mesin e 245 bankave më aktive në tregun ndërkombëtar të financimit të projekteve, pesë në listën e dhjetë bankave më të mira, janë banka evropiane. Kultura e bankave evropiane të përfshira përmes teknikës së financimit të projekteve të investimeve afatgjata dhe financimit të projekteve që mbështesin rritjen e qëndrueshme ekonomike, është e pranishme (jo) drejtpërdrejt edhe në rajonin e Ballkanit Perëndimor, nëpërmjet lidhjes së tyre natyrale me bankat vendase (që janë aktive brenda të njëjtit grup bankar). Kështu, bankat që operojnë në rajonin e Ballkanit Perëndimor, edhe pse jashtë BE-së, mund të ofrojnë ekspertizë dhe kapacitete financiare, njerëzore, si dhe kapacitete të tjera, për realizimin e modelit të rritjes së ekonomisë në tregun e brendshëm. Për shkak të kapacitetit të tyre të përgjithshëm, ato mund të përfaqësojnë një partner të rëndësishëm dhe ndoshta kyç në financimin e një rritjeje të qëndrueshme në ekonominë e tyre përkatëse, të cilat janë po përballen me nevoja të mëdha zhvillimi dhe me kufizime serioze në buxhet.

Sistemi bankar në Malin e Zi “Fotografia në kornizë”

Besoj se konkurrenca e tregut dhe një mjedis i favorshëm biznesi do të çojnë në një vëllim të shtuar të huave. Me futjen e produkteve të reja bankare, nëpërmjet procesit të digjitalizimit, konsumatorët do të kenë qasje më të lehtë në të gjitha shërbimet financiare.



Nebojša ĐOKOVIĆ, MSc

Këshilltar

SHOQATA E BANKAVE E MALIT TË ZI

Sistemi bankar në Mal të Zi është përballur me shumë sfida gjatë gjatë dhjetëvjeçarëve të fundit, por në ditët e sotme ai karakterizohet nga: siguria, stabiliteti dhe besueshmëria. Të gjithë treguesit kryesorë, si: likuiditeti, aftësia paguese dhe mjaftueshmëria e kapitalit, arrihen në nivelin e tyre maksimal, përgjatë viteve të fundit. Për disa institucione financiare sugjerohet konsolidimi i mundshëm, ndërsa nga ana tjetër ka kërkesa të shumta të institucioneve financiare për të hyrë në tregun malazez.

Aktualisht, në Maline Zi funksionojnë 15 banka dhe shumica e tyre janë bija të bankave mëmë që veprojnë në shtetet anëtare të BE-së. Të gjitha bankat janë anëtare të Shoqatës së Bankave të Malit të Zi. Ky i fundit është në proces të pranimit në BE dhe negociatat e kapitullit 9, që i referohet shërbimeve bankare dhe financiare u hapën para

pak vitesh. Për këtë qëllim, baza rregullatore është përshtatur sipas dinamikës së planifikuar, kështu që, ligj i ri për Institucionet e Kreditit do të miratohet brenda tremujorit të tretë të vitit 2019, së bashku me gjithë aktet nënligjore përkatëse. Kjo do ta harmonizonte thelbësisht kuadrin rregullator bankar me atë të BE-së dhe harmonizimi i plotë do të realizohej me pranimin e Malit të Zi në BE (diku rreth vitit 2025).

Në nivel sistemi, sektori bankar në Mal të Zi regjistroi prirje pozitive, ku të gjithë treguesit kyç të bilancit shënuan rritje, si: totali i aktiveve u rrit me 5.52% në fund të tremujorit të tretë të 2018-ës, krahasuar me fundin e vitit të kaluar, ndërsa portofoli i huave gjithsej u rrit me 10.70%, totali i depozitave u rrit me 5.88% dhe totali i kapitalit u rrit me 0.83 %.

Raporti i aftësisë totale paguese, si një tregues relativ i mjaftueshmërisë së kapitalit të bankave, ishte 17.15%, në fund të tremujorit të dytë të vitit 2018, duke qenë shumë më lart se minimumi ligjor prej 10%. Përveç kësaj, aktivet likuide tejkalojnë nivelin prej 1,037.9 milionë euro në fund të shtatorit 2018, duke zënë mbi 23.52% të totalit të aktiveve të bankave, ose gati një e katërta e totalit të aktiveve bankare. Këto aktive, sipas përkufizimit konservator që ka përdorur Banka Qendrore për aktivet likuide, përfshijnë vetëm paranë e gatshme, fondet në llogari rrjedhëse, depozitat pa afat në banka dhe gjysma e rezervës së detyrueshme të bankave. Kjo do të thotë që pozicioni i likuiditetit të

bankave është jashtëzakonisht i fortë dhe sistemi bankar, në tërësi, ka një sasi të mjaftueshme kapitali për të mbuluar të gjitha rreziqet, kundrejt të cilave është ekspozuar tashmë.

Spektori bankar karakterizohet nga prirjet pozitive, edhe në fushën e përfitueshmërisë. Kështu, deri në fund të shtatorit 2018, sistemi bankar raportoi një fitim neto total prej 29.9 milionë euro. Kthimi total i aktiveve në tremujorin e dytë të 2018-ës (ROA) rezultoi në 1.49% dhe kthimi nga kapitali (ROE) ishte 12.58%. Në shtator 2017, ROA dhe ROE ishin përkatësisht 0.84% dhe 6.53%.

Niveli i huave me probleme, si një tregues i cilësisë së portofolit të huave bankare, ka regjistruar një prirje të fortë dhe të vazhdueshme rënëse. Raporti i huave me probleme (NPL) ndaj totalit të huave u zvogëluar ndjeshëm në raport me vitet e kaluara. Konkretisht, nga niveli prej mbi 25% në vitin 2011, këto hua shënuan një rënie prej 6.71%, që dëshmon për një dinamikë të shkëlqyer të uljes së huave me probleme. Veprimtaritë e ndërmarra nga Banka Qendrore e Malit të Zi, gjatë viteve të kaluara, kontribuan në këtë dinamikë të reduktimit të huave me probleme, sikundër dhe veprimtaritë e kryera nga Shoqata e Bankave dhe vet bankat. Vlen të theksohet se Banka Qendrore u kërkoi bankave të përgatisin një strategji trevjeçare të zgjidhjes së çështjes së huave me probleme, zbatimin e të cilave monitorohet dhe mbikëqyret vazhdimisht. Për më tepër, ligji për ristrukturimin vullnetar të borxhit financiar (Modeli Podgorica) u ndryshua, me qëllim nxitjen e rimëkëmbjes së debitorit, që në kthim do të ndikonte në likuiditetin e ekonomisë. Rezultatet e legjislacionit të ndryshuar, të cilat do të mbeten në fuqi deri në maj 2019, janë të kënaqshme. Në shtator 2018, totali i huave të ristrukturuara arriti në 36.7 milionë euro. Ndërkohë, në vijim priten efekte të mëtejshme pozitive nga zbatimi i këtij ligji. Bankat transferuan hua të këqija

te shoqëritë e tyre të faktoringut, si dhe shitën pjesë të portofolit të huave me probleme. Sot, bankat zbatojnë politika më shtrënguese huadhënie në krahasim me dhjetë vjet më parë, ndërkohë që baza ligjore ka ndryshuar thelbësisht.

Duke pasur parasysh nivelin aktual të huave me probleme në nivelin e sistemit, arihet në përfundimin se huat me probleme nuk janë më problem sistematik, por një problem i disa bankave, që duhet të bëjnë përpjekje shtesë për t'i zvogëluar ato më tej.

Për sa i përket krahasimit të normave të interesit për kursimet në Mal të Zi me ato të vendeve të rajonit dhe në BE, mund të vërehet se ato janë disi më të larta, pasi ato variojnë nga 1.2% deri në mbi 2% në vit, ndërkohë që ato janë me shenjë negative në shumë shtete anëtare të BE-së. Përveç kthimit, i cili nuk është i lartë, mbajtja e parave në banka jep efektin e sigurisë, pra

nuk ka rrezik për vjedhje dhe të gjitha depozitat deri në 50,000 euro në Mal të Zi sigurohen nga Fondi i Mbrojtjes së Depozitave. Në të ardhmen, kjo shumë planifikohet të rritet deri në 100,000 euro.

Një konkurrencë e madhe në treg, që zhvillohet në një territor relativisht të vogël tregon se Mali i Zi është kthyer në një destinacion tërheqës për investime. Politika fiskale, heqja e barrierave për biznesin, përdorimi i euros si monedhë vendase dhe përafrimi i legjislacionit me atë të BE-së kontribuojnë në rritjen e numrit të investuesve dhe hyrjen e mundshme të bankave të reja në Malin e Zi. Në këtë drejtim, besoj se konkurrenca e tregut dhe një mjedis i favorshëm biznesi do të çojnë në një vëllim të shtuar të huave. Me futjen e produkteve të reja bankare, nëpërmjet procesit të digjitalizimit, konsumatorët do të kenë qasje më të lehtë në të gjitha shërbimet financiare.



Kreditimi, një vështrim ndryshe

Formalizimi i mëtejshëm i ekonomisë është një tjetër element që kërkon shumë vëmendje, në kuadrin e nxitjes së huadhënies nga shkaku i rritjes së besueshmërisë së analizave financiare. Ky është një proces i cili duhet të vazhdojë!



Bardhi SEJDARASI

Sekretar i Përgjithshëm
LIDHJA E GAZETARËVE EKONOMIKË TË
SHQIPËRISË

Asnjëherë nuk është i tepërt (i dalë jashtë kohe) një diskutim i hapur, pse jo edhe një debat lidhur me kreditimin e ekonomisë. Shqipëria, shqiptarët, bizneset e sektorit financiar që ofrojnë shërbimin e tyre për sektorin jofinanciar (bizneset dhe individët), e kanë të nevojshëm një debat të tillë, por ai mungon, ose më mirë të themi, është i mbyllur në qerthullin e një grupi shumë të vogël njerëzish e subjektësh. Pse duhet të ndodhë kjo?

Historia shqiptare e shërbimit financiar ka shënuar ulje – ngritjet e saj. Bankat janë ndodhur në dilemën e zgjedhjes midis huave me probleme dhe vetsigurimit të fitimeve. Sistemi financiar bankar duhet të shohë me sy kritik faktin që, gjatë një periudhë të caktuar të dy dhjetëvjeçarëve të fundit, standardet e kreditimit u lehtësuan

dhe kushdo mund të aplikonte e të merrte një hua, sipas kushteve apo praktikave të shitësit të parasë. Sakaq, blerësit jofinanciarë duhet të ndjehen të turpëruar që prej vitesh blejnë para’ e vijojnë ende ta bëjnë këtë gjë, me letra të gënjeshtëra, me pasqyra financiare (bilance) të



Kërkesa për hua, ndonëse në rritje, vlerësohet relativisht e ulët. Ulja rreth 18 herë e normës bazë të interesit (instrumenti përmes së cilit Banka e Shqipërisë ndikon tërthorazi tregjet financiare) gjatë 6 viteve të fundit, ka ndikuar më shumë në largimin e kursimeve me afat nga bankat, sesa në nxitjen e kreditimit, ndërsa rënia e interesave mesatare të huas nuk ka dhënë efektet e pritura në huadhënie.



pavërteta, duke gënjyer, së pari, jo vetëm bankat, por veten e tyre e, në finale po e gjejnë veten në batakun e falimentit të merituar.

Po kjo është vetëm njëra ana e medaljes. Praktika e dy dhjetëvjeçarëve të fundit ka treguar se aktorët jofinanciarë i janë vërsulur shtetit, i cili nuk “i ndihmon” ata të marrin hua, për të rritur dhe zhvilluar bizneset e tyre. Shteti ka qënë “fajtori” (sipas tyre) edhe në vitet kur huadhënja ka kapur majat, apo edhe kur kreditimi i ekonomisë dhe i biznesit ka njohur

“gropa” të pamerituara! Në fakt, “shteti” i tyre duhet shpallur fajtor për një tjetër gjë: për mosveprimin e tij, për mosqenien si një arbitër i ndershëm, në një treg ku të tjerët luajnë dhe “shteti” përfiton! “Shteti” ka thuar se tri dekada ku bën sehir që “vështron” bilancet e dyfishta të biznesit! A duhet të ndërhyjë ai në këtë situatë? Ai ka të gjitha mekanizmat ligjorë dhe institucionalë për të ndërhyrë, për të vënë rregull, për të vënë në pozita të barabarta dhe të ndershme shitësin dhe blerësin e parave. Në pjesën dërrmuese të kohës nuk e ka kryer një detyrë të tillë plotësisht, pavarësisht se ka një lëvizje në kahun e duhur, sa i përket ndalimit të bilanceve të dyfishta: “njërin për bankat, tjetrin për tatimet!” Gjithashtu, pak u bë për të larguar nga tregu ata që e dëmtojnë tregun e shitblerjes së parave për investime e biznes, që huat me probleme i çuan në stratosferë. A ka shembuj? Patjetër! Ligji i vjetër i falimentit nuk krijoi asnjëherë mundësinë e ekzekutimit real të një shoqërie tregtare. Shumë burime u harxhuan për një ligj të ri, bashkëkohor dhe të vlerësuar të falimentit, por ai vijon të ecë me një “këmbë”. Prej vitesh ai nuk është plotësuar me aktet ligjore e nënligjore, duke mos qënë plotësisht i zbatueshëm – në fund të ditës – për të ndihmuar bankat të marrin mbrapsht fondet e dhëna hua! Sot pak flitet për ligjin e falimentit, të hartuar nga institucione prestigjioze ndërkombëtare, që duket më shumë fle se sa zbatohet. Po cili është efekti? Kemi ende shume hua, të cilat nuk ripaguhen

JU KËRKONI TI LARGOHENI
SË PËRDITSHMES.

NE JU HAPIM DYERT PËR
TË ZBULUAR NJË DUBAI
TË JASHTËZAKONSHËM.



Gjeni aventurën tuaj me Visa nga Credins Bank në Dubai Shopping Festival.

Relaksohuni në hotelet më të mira, shijoni gatimet që keni ëndërruar gjithmonë, përjetoni spektakle të paharruara dhe kënaquni duke blerë me zbritjet dhe ofertat që përfitoni duke përdorur kartat Visa nga Credins Bank gjatë Festivalit të Blerjeve Dubai duke nisur nga 26 Dhjetori 2018 deri në 02 Shkurt 2019.

Mëso më shumë në: www.bankacredins.com/dsf



KEY SPONSOR

VISA



nga huamarrësit, që nuk kanë aftësi teknike paguese për t'i kthyer ato. Sa do vazhdojnë të qëndrojnë kështu?

Duke parë disa muaj më parë propozimet interesante të komunitetit të bankierëve shqiptarë drejtuar ekzekutivit shqiptar për t'i përfshirë në paketën fiskale, që shoqëron buxhetin vjetor të shtetit, vihej re një fakt interesant: asnjë nga propozimet profesionale të biznesit bankar nuk është përfshirë në paketën e re të 2019-ës! Pse? Nuk ka përgjigje! Si në kalendat greke shkoi edhe përpjekja e mirë për të rregulluar sistemin e kostove të përmbauesve shqiptarë, që rreken të ekzekutojnë kolaterale të bankave! Pas aq shumë përpjekjeve, më në fund, gjykata administrative e zgjidhi ngërçin. Udhëzimi i gushtit 2018 është në fuqi! Kot nuk thonë: shpresa vdes e fundit. Gjithsesi, ekonomia nuk mund të ushqehet me shpresa, ajo kërkon kapital, kërkon kreditim, kërkon rregulla loje të qarta, të sakta dhe të prera!

Çfarë e pengon kreditimin?

Asgjë! Kushtet e përgjithshme ekonomike dhe financiare, gjendja e shëndetshme e sistemit bankar, politika monetare e ndjekur, si dhe faktorë të tjerë, kanë krijuar një mjedis favorizues për kreditimin e ekonomisë. Kjo shprehje statike në raportet e autoriteteve dëshmon se në Shqipëri ka parà, por nuk ka KAPITAL! Në terrenin konkret kemi një gjë që i vlen ta vlerësojmë: ky është mirëkapitalizimi i bankave tregtare, likuiditeti i mjaftueshëm dhe maturiteti në rritje i këtij tregu! Pra, kemi parà! Tani na

duhet të kemi edhe kapital! E këtu ndahen pozicionet. Disa pohojnë që bankat janë "të shtrënguara" e "nuk japin hua"! Të tjerë thonë që sektori bankar duhet "të adoptojë një përqasje proaktive, për të shfrytëzuar më mirë mundësitë ekzistuese dhe për të rritur ndërmjetësimin financiar". Disa në anën e qeverisë nënvizojnë se "duhet mbështetur sektori bankar, duke thjeshtuar më tej barrierat ligjore dhe ato procedurale", që industria bankare i gjykon si faktorë që ndikojnë negativisht në cilësinë e portofolit të huas dhe në zgjerimin e mëtejshëm të tij. Bankierët, përveç konstatimit të një kërkesë ende të dobët, që industria bankare e shikon si problem, këmbëngulin në mungesën e njëtrajtshmërisë në zbatim, apo nevojën për përmirësim të kuadrit ligjor që shoqëron procesin e ekzekutimit të kolateralit dhe falimentimin e subjekteve. Vëllimi i huas së dhënë nga bankat për bizneset dhe konsumatorët shqiptarë nuk është në stanjacion, por të dhënat e BSH-së tregojnë rënie, sidomos kredia për biznes. Sigurisht, këtu është efekti i kursit të këmbimit, i fshirjes së huave etj. Por përgjatë pesëmbëdhjetë viteve të fundit bankierët kanë thënë gjithmonë se një ekonomi e re si Shqipëria, do të përjetojë rritje të kreditimit me 10 - 15 për qind në vit, për shkak se vëllimi i huas në duart e biznesit dhe konsumatorit ka pasur pikën fillestare thujse zero.

Bankë - biznes, një marrëdhënie të vështirë

Banka e Shqipërisë, që prej shtatorit të vitit 2011, po ndjek një

politikë lehtësuese monetare (uljen e kostos së parasë), duke e ulur normën bazë të interesit, por kjo nuk ka dhënë efekt të dukshëm në zgjerimin e huas. Politika monetare është konsumuar ekstremisht në favor të zgjerimit të huadhënies, por kërkesa për hua për investime dhe konsum nuk është rritur aq sa ka nevojë zhvillimi ekonomik i vendit. Nga ana tjetër, ulja e normave të interesit të huas në nivele historike ka ndihmuar në zhvendosjen e kërkesës për hua drejt monedhës vendase, por dinamika e rritjes së huas mbetet e moderuar. Kërkesa për hua, ndonëse në rritje, vlerësohet relativisht e ulët. Ulja rreth 18 herë e normës bazë të interesit (instrumenti përmes së cilit Banka e Shqipërisë ndikon tërthorazi tregjet financiare) gjatë 6 viteve të fundit, ka ndikuar më shumë në largimin e kursimeve me afat nga bankat, sesa në nxitjen e kreditimit, ndërsa rënia e interesave mesatare të huas nuk ka dhënë efektet e pritura në huadhënie.

Më pëlqen të citoj një Drejtor të Përgjithshëm të një prej bankave të vendit, kur thotë se: "sistemi bankar nuk arrin të rritet më shumë se ekonomia e vendit". Duke e parë gotën në gjysmën e saj të plotë, them se sistemi bankar gjithsesi vazhdon të rritet dhe rritja vjen nga përmirësimi i mëtejshëm i infrastrukturës së huadhënies. Formalizimi i mëtejshëm i ekonomisë është një tjetër element që kërkon shumë vëmendje, në kuadrin e nxitjes së huadhënies nga shkaku i rritjes së besueshmërisë së analizave financiare. Ky është një proces i cili duhet të vazhdojë!



Krimi kibernetik, kërcënimi dhe rreziku

Realiteti kibernetik është toka e re ku njerëzimi duhet të fillojë të formojë qytetet e reja dhe kjo kërkon atë që ne e kemi në formën tradicionale vetëm se tashmë çdo gjë është virtuale.



Dr. Hergis JICA¹

Kryekomisar

Njësia për krimin kibernetik

POLICIA E SHTETIT

Nëse do të flisim shkurtimisht për krimin kibernetik, atëherë do të duhej të analizojmë metodat, prirjet dhe shtrirjen e tyre, por dhe rreziqet që lidhen me pastrimin e parave. Pas kësaj këto rreziqe do të mund t'i ndanim në katër grupe kryesore siç janë:

- Teknologjike;
- Operacionale;
- Rregullatore;
- Juridiksionale.

Kjo ndarje është shumë e përgjithshme dhe për të kuptuar saktësisht se çfarë përfaqësojnë ato nevojitet një analizë më e plotë dhe më e detajuar, duke pasur parasysh gjithmonë përballjen e shoqërisë dhe shtetit me kërcënimet dhe dobësitë që ato kanë ndaj krimit kibernetik. Gjithashtu, pjesë e rëndësishme janë dhe pasojat që mund të ketë, por dhe masat që duhen ndërmarrë, për menaxhimin dhe minimizimin e tyre. Duke u bazuar në pjesën më kryesore,

por dhe se si ndahet krimi në internet, mund të përcaktohen lehtësisht disa kërcënime kryesore për një shoqëri, por pse jo, edhe për vetë shtetin. Këto lloj kërcënimesh do të ishin:

Hapja e shtetit dhe shoqërisë ndaj sistemeve kompjuterike. Sistemet kompjuterike që përdoren sot ofrojnë mjedis të favorshëm për furnizimin ndërkombëtar të mallrave, ofrimin e shërbimeve të ndryshme financiare ose jo, por dhe transferimin e fondeve të ndryshme ndërmjet individëve



Gati në të gjitha rastet, veprat penale të krimit kibernetik kryhen nga grupe të organizuara personash, apo grupe të cilat mund t'i quajmë "të përziera". Veprat penale që përfundojnë me "sukses" mund të kryhen vetëm nëpërmjet një përgatitje dhe organizimi të saktë, gjë që në fakt e bën krimin kibernetik një krim të organizuar.



dhe personave juridikë. Këto sisteme kompjuterike janë të lidhura në internet, e në të njëjtën kohë, edhe informacioni i mbledhur mund të ruhet po aty, pra, në internet. Pavarësisht nga gjithë këto mundësi të reja që sjell përdorimi i sistemeve kompjuterike, në krahu tjetër krijohet një hapësirë e gjerë për kryerjen e veprave të ndryshme kriminale kibernetike, si dhe për pastrimin e të ardhurave të këtyre krimeve, si dhe të veprave të tjera që kryhen, si pasojë e përdorimit të teknologjisë kompjuterike;

Krimi Kibernetik është i shpejtë por me kosto të ulët. Sistemet kompjuterike të lidhura me njëri-tjetrin krijojnë infrastruktura teknologjike të cilat u krijojnë keqbërësve kibernetikë të kenë qasje të shpejtë në çdo dhënë kompjuterike, si dhe në sisteme të pavaruara të pagesave online. Këto sisteme janë ato që ju mundësojnë atyre fshehjen e gjurmëve, por dhe transferimin e fitimeve të tyre nga veprimtaria kriminale dhe patjetër kjo ka një kosto mjaft të ulët për ta;

Krimi kibernetik është një vepër penale e teknologjisë së lartë. Rritja e shpejtë e teknologjisë së informacionit dhe vështirësia në përballjen me këtë lloj fushe, duke e ndërlidhur këtë vështirësi me procesin e gjatë por dhe tepër burokratik për krijimin e legjislacionit dhe kuadrit rregullator përkatës, çojnë në një situatë ku masat e marra për të parandaluar dhe luftuar krimin kibernetik janë shpeshherë të pamjaftueshme ose nuk ekzistojnë;

Krimi kibernetik ka natyrë komplekse. Përdorimi i teknologjisë kompjuterike, rrjeteve të informimit dhe komunikimit, por dhe nxitja dhe nga motivimet sociale u siguron autorëve të veprave penale të krimit kibernetik fitime financiare dhe materiale, por gjithashtu edhe një nivel shoqëror të caktuar, në brendësi të hapësirës virtuale. Autorët e krimeve kibernetike janë të angazhuar në shumë raste dhe për diskreditimin e qeverive dhe vendeve të ndryshme, duke krijuar faqe interneti me përmbajtje terroriste, duke dëmtuar,

¹ Msc. Shkenca Ekonomike, Msc. Shkenca Penale, Msc.(c) Siguri Kibernetike.

shkatërruar, futur të dhëna të rreme, ose t'i bëjnë sistemet kompjuterike të paoperueshme.

Anonimiteti i krimit kibernetik.

Mungesa e kontaktit të drejtpërdrejt fizik, përgjegjësia penale relativisht e vogël si dhe vështirësitë shpeshherë të mëdha në identifikimin e autorëve, apo qoftë dhe në mbledhjen e informacionit të mjaftueshëm në hapësirën virtuale, e bëjnë krimin kibernetik jashtëzakonisht tërheqës për kriminelët;

Krimi kibernetik ka përhapje të gjerë juridiksionale.

Krimi kibernetik ka një natyrë specifike, për sa i përket juridiksionit, pasi është një vepër që mund të përgatitet dhe kryhet nga thuajse çdo vend, ku mund të ketë qasje në internet. Duke pasur një rritje gjithnjë e më të madhe të shërbimeve nëpërmjet internetit dhe kur popullsia që përdor pajisje kompjuterike është vjen gjithnjë në rritje, për rrjedhojë edhe krimi kibernetik po bëhet gjithnjë e më i përhapur. Kjo lloj natyre e krimit kibernetik është tepër tërheqëse për kriminelët, pasi ata mund të veprojnë nga vende me juridiksione të ndryshme dhe shpeshherë nga vende ku këto vepra nuk ndëshkohen, të ardhurat nga krimi nuk kontrollohen, monitorimi i tyre është gati i pamundur si dhe mund të krijojnë kushte të favorshme edhe për vepra të tjera penale, që rrjedhin nga fusha e teknologjisë dhe informacionit. Disa juridiksione përdoren nga kriminelët për të bërë shpërndarjen e fitimeve nga veprimtaria kriminale dhe në këtë formë rrjedhat monetare drejtohen vazhdimisht në këto vende, e në të njëjtën kohë, gjenerohen rrjedha monetare nga këto vende në juridiksione të tjera, me qëllimin humbjen e gjurmëve;

Gati në të gjitha rastet, veprat penale të krimit kibernetik kryhen nga grupe të organizuara personash,

apo grupe të cilat mund t'i quajmë "të përziera". Veprat penale që përfundojnë me "sukses" mund të kryhen vetëm nëpërmjet një përgatitje dhe organizimi të saktë, gjë që në fakt e bën krimin kibernetik një krim të organizuar. Kriminelët kibernetikë zakonisht kërkojnë të kryejnë veprime që do të sjellin fitime të larta, që çon në rritjen e krimeve kibernetike në sektorin financiar, por nga ana tjetër, kryerja e krimeve të tilla kërkon njohuri të ndërveprimeve financiare, veprimtarisë dhe pajisjeve të sistemit bankar, etj. Përveç kësaj, kriminelët kibernetikë përdorin në mënyrë të shpeshtë shërbimet e kriminelëve "tradicionale", me anë të të cilëve ata mund të konvertojnë përfitimet në para fizike.

Të gjitha më sipër nxjerrin një nevojë urgjente dhe të vazhdueshme për zhvillimin e metodave mbrojtëse për sistemin e mbrojtjes kibernetike, të cilat lidhen kryesisht me:

- Zbulimin në kohë të veprave penale të krimit në internet;
- Dokumentimin hap pas hapi të problematikave, pasi duke u nisur nga kohëzgjatja dhe kompleksiteti i hetimit të këtyre veprave, përdorimi i të dhënave dhe provave elektronike gjatë ndjekjes penale bëhet i vështirë.

Disa karakteristika të sistemeve elektronike të pagesave të cilat mund të jenë të lehta për t'u krijuar e që kërkojnë kostot e ulët për përmirësimin e mëtejshëm të tyre mund të jenë ndër faktorët që tregojnë rreziqe potenciale të pastrimit të parave. Shpejtësia e lartë e transaksioneve, duke përfshirë transfertat ndërkufitare të parave, lehtëson skemat e ndryshme të pastrimit të parave. Shpenzimet e vogla lidhur me transaksione të tilla ulin koston e shërbimeve të pastrimit të parave dhe inkurajojnë kriminelët të kërkojnë burime të reja të të ardhurave të paligjshme. Fakti

që të përfitimet mund të konvertohen lehtësisht në para fizike, ose në para të gatshme për t'u tërhequr, mund t'u lejojnë autorëve të pastrojnë fitimet e krimit në shumë juridiksione. Në vijim, ka rritje të numrit të veprave penale në internet dhe kjo ka sjellë jo rrallë herë dhe rënie të besimit të publikut në integritetin e sistemit financiar, sekretin bankar, mbrojtjen e të dhënave personale dhe transaksionet financiare, të cilat gjithnjë e më shumë po kryen duke aplikuar teknologjitë e reja.

Nëse do të kemi një humbje të besimit nga publiku ndaj shërbimeve të ndryshme financiare do të kishim më pak angazhime të popullatës në zhvillimin ekonomik. Këto angazhime mund të përkthehen në pasoja, që mund të jenë si më poshtë:

- Financiare: humbje të institucioneve të ndërlidhura, klientëve të tyre, fitimet e humbura të aksionerëve, etj.
- Besueshmëria: nxjerrja e informacionit konfidencial, si: të dhëna bankare dhe të dhëna personale; humbja e besueshmërisë së konsumatorëve në sistemin bankar në përgjithësi dhe në shërbimet bankare "online", që sjell zvogëlimin e transaksioneve "pa para fizike", etj.
- Juridike: kërkesat e konsumatorëve, etj.
- Teknologjike: institucionet bankare detyrohen të përdorin mjete dhe produkte sigurie shpeshherë të shtrenjta dhe të ndërlikuara, për të siguruar funksionimin e besueshëm sistemeve kompjuterike dhe telekomunikimit, për të siguruar të dhënat që administrojnë.

Realiteti kibernetik është toka e re ku njerëzimi duhet të fillojë të formojë qytetet e reja dhe kjo kërkon atë që ne e kemi në formën tradicionale vetëm se tashmë çdo gjë është virtuale.

Bashkëpunimi publik – privat në ndërgjegjësimin rreth rreziqeve kibernetike

Fushata e EBF – Europol-it kundra mashtrimeve kibernetike

Fushata kundra mashtrimeve kibernetike është një shembull se çfarë mund të arrihet kur bashkojnë forcat sektori publik dhe ai privat. Zgjerimi i shpejtë i digjitalizimit, vëllimet e mëdha të të dhënave personale që qarkullojnë në internet dhe ndërlidhja e pashembullt e sistemeve, gjërave dhe njerëzve nuk mund të tolerojnë padijen, kur bëhet fjalë për sigurinë tonë digjitale.



Alexandra MANIATI

Këshilltore e lartë për Politikën, Sigurinë Kibernetike & Aftësitë Digjitale
FEDERATA BANKARE EVROPIANE (EBF)

Një grup kriminelësh, i quajtur "grupi Carbanak/Cobalt", arriti të vjedhë qindra milionë euro nga mbi 100 banka në 40 vende, duke hyrë në programin e ATM-ve. Modus operandi i tyre ishte i thjeshtë dhe i zgjuar: komandat e lidhura me pajisjet fizike të ATM-ve u manipuluan në mënyrë të tillë, që hacker-at të mund të programonin makinat e parave në mënyrë të tillë që ato të nxirrnin paratë në një kohë të caktuar. E vetmja gjë që duhej sistemuar pas kësaj ishte të dërgonin bashkëpunëtorët e tyre në vendin e duhur, në kohën e

duhur, për të marrë kartëmonedhat që dilnin nga ATM-të. Po si arritën kriminelët të kenë qasje në sistemet e bankave dhe çfarë mund të bëhet për të shmangur incidente të tilla në të ardhmen?

Për të ndryshuar komandat e programit, nevojitet instalimi i një virusi (kodi) të fortë, për të korruptuar parametrat ekzistuese. Me fjalë të tjera, është i nevojshëm një skedar "malware" për të infektuar kompjuterin që lidhet me sistemin që synohet të manipulohet. Për t'i instaluar këto skedarë shkatërrues në pajisjen që është e lidhur me infrastrukturën e ATM-ve, hacker-at Carbanak/Cobalt dërguan qindra e-mail-e me "malware" bashkëngjitur, duke synuar punonjësit që punonin në departamentet përkatëse. Duhej veç një punonjësi që të hapte skedarin bashkëngjitur një e-mail-i të tillë. Gabimet njerëzore ndodhin dhe këtu vihet theksi për rritjen e ndërgjegjësimit mbi rrezikun kibernetik. Statistikat evropiane nxjerrin se 43% (nga 165 milionë) e evropianëve nuk kanë aftësitë bazë digjitale dhe kjo ndodh ndërkohë që 95% e sulmeve kibernetike të suksesshme aktivizohen nga ndonjë gabim njerëzor, i qëllimshëm apo jo. Në një numër të konsiderueshëm rastesh, sulmuesit luajnë me

psikologjinë dhe sjelljen njerëzore, duke përdorur shpesh teknika të inxhinierisë sociale, për të mashtruar njerëzit në zbulimin e informacionit me ndjeshmëri (p.sh. fjalëkalimet ose kredencialet bankare), ose kryerjen e veprimeve specifike. Ky lloj manipulimi, i shoqëruar me mungesën e njohurive digjitale të vet-mbrojtjes, bën që gjithkush prej nesh të jetë një objekt i mundshëm, jo vetëm në transaksionet tona financiare, por në të gjitha aspektet e jetës sonë digjitale.

Në raste si goditja e Carbanak/Cobalt, faza e përgatitjes i paraprin dërgimit të e-mail-ëve të virusuar. Për të identifikuar objektivat e tyre, sulmuesve u duhet të mbledhin informacion mbi bankën e synuar (ose ndonjë shoqëri tjetër në fjalë), departamentin përkatës dhe njerëzit që punojnë atje. Nëse, për shembull, një departament është në procesin e shqyrtimit të kandidatëve për një vend vakant, një e-mail i virusuar që përmban një kërkesë në dukje origjinale me një CV (malware) bashkëngjitur do të ishte gjetja e duhur. Nëse të dhënat tremujore duhet të raportohen gjatë kësaj periudhe kohore, skedarëve që i ngjanë një raporti të rregullt të shoqërisë mund t'i bashkëngjitet një malware.

Më tej pastaj, si i marrin sulmuesit adresat e e-mail-ave të punonjësve të synuar? Me këtë rast, mund të përdoren malware të tjerë ose inxhinieria sociale, për të hyrë në listën e punonjësve të brendshëm, për të identifikuar se kush punon atje. Për më tepër, profilet dhe postimet në mediat sociale mund të kombinohen për të prodhuar informacionin e nevojshëm. Në ditët e sotme, vjedhja e të dhënave është po aq e rëndësishme dhe fitimprurëse se sa vjedhja e parave. Po cila është përgjigja? Ky shembull – një nga të shumtit – thekson rëndësinë e rritjes së ndërgjegjësimit për rreziqet e mashtrimit kibernetik dhe nevojën për një higjienë kibernetike. Ajo tregon se siguria kibernetike nuk është vetëm një çështje e sistemeve dhe ekspertëve të TIK-ut. Ajo është një përgjegjësi e përbashkët, që kërkon një kulturë krejt të re të sigurisë kibernetike, që duhet të ushqehet në të gjithë ne, fuqia punëtore dhe qytetarët, duke filluar me sjelljen e thjeshtë: "mendo përpara se të klikosh".

Fushatat e EBF – Europol-it kundra mashtrimeve kibernetike

Përshtatja e sjelljes, shprehive dhe aftësive në kontekstin e ri digjital është një objekt afatgjatë, që mund të arrihet vetëm me veprime në shkallë të gjerë, të vazhdueshme dhe efektive, të cilat kërkojnë bashkëpunim të fortë publik-privat. Federata Bankare Evropiane (EBF), me rrjetin e saj shumë të gjerë prej

32 shoqatash bankare dhe 3,500 bankash në të gjithë Europën, ka ekspertizën për të trajtuar të gjitha çështjet që lidhen me bankat, por gjithashtu edhe kapacitetin për të shpërndarë informacion dhe për të rritur ndërgjegjësimin, nëpërmjet një numri shumë të madh grupesh



interesi dhe anëtarësh. Mbështetur në një besim të fuqishëm në bashkëpunimin serioz publik-privat, EBF nënshkroi, që prej vitit 2014, një Memorandum Mirëkuptimi me agjencinë evropiane ligjzbatuese - Europol. Objektivi i Memorandumit të Mirëkuptimit ishte forcimi i bashkëpunimit midis sektorit bankar evropian dhe Qendrës Evropiane për



Krimin Kibernetik (EC3) në tre nivele: bashkëpunim operacional, shkëmbim i informacionit dhe rritje të ndërgjegjësimit. Rezultati më i fundit i këtij partneriteti në rritjen e nivelit të ndërgjegjësimit është fushata e përbashkët EBF-Europol kundra mashtrimeve kibernetike. Informacioni i ardhur nga anëtarët e EBF-së dhe vrojtimi vjetor i vlerësimit të kërcënimeve kibernetike të Europol-it (iOCTA) treguan një prirje rritëse të

mashtimeve dhe viruseve online përgjatë viteve dhe gjithashtu një rritje të sofistikimit të tyre. Për fushatën e re u përzgjedhën shtatë mashtrimet më të shpeshta, të gjitha të bazuara në inxhinierinë sociale, me qëllim që viktimat të zbulonin të dhëna të ndjeshme dhe/ose të kryenin veprime që rezultonin në humbje financiare:

Ekipi EC3 i Europol-it dhe Grupi i Punës për Sigurinë Kibernetike të EBF-së, me një përkrahje shumë të fuqishme nga anëtarët, punuan ngushtë për thujt një vit, për të zhvilluar skenarin e fushatës (sinjalet që duhen mbajtur parasys për të identifikuar mashtrimet, këshilla se si të mos biesh viktimë, ose si duhet proceduar nëse bie viktimë), që do t'i përshtateshin audiencës pjesëmarrëse nga agjencitë policore dhe shoqatat e bankave. Kjo u transformua më pas në një material tërheqës dhe të lehtë për t'u kuptuar, që u përkthye në të gjitha gjuhët e BE-së.

Përfundimisht, u krijua një set i plotë, me të gjitha materialet, por dhe me mesazhet e sugjeruara për median, për promovimin e fushatës. Kjo bëri që pragu i pjesëmarrjes të ishte jashtëzakonisht të ulët, duke bërë që edhe shoqata më të vogla bankash ta mbështesnin atë, pavarësisht se kapacitetet e tyre të komunikimit ishin relativisht të ulëta. Fushata u lançua zyrtarisht më 17 tetor 2018, gjatë konferencës vjetore të EBF-së për Sigurinë Kibernetike në Bruksel dhe në kuadër të muajit evropian të sigurisë kibernetike, nga Steven Wilson, Drejtor i Qendrës Evropiane për Krimin Kibernetik të Europol-it dhe Wim Mijs, nga Federata Bankare Evropiane.

Kanalet e mediave sociale dhe faqet e internetit që përdoren në mënyrë aktive nga shoqatat e bankave dhe vet bankat mundësuan arritjen e një audiencë të madhe



Lançuar më 17 tetor

- Në Konferencën e 2-të EBF-së për Sigurinë Kibernetike
- Mirëpritur nga 34 vende



dhe të larmishme. Fushata kundra mashtrimeve kibernetike mirëpriti 34 vende pjesëmarrëse në të gjithë Europën dhe më gjerë të mbështetur, ndër të tjera, nga 24 shoqata kombëtare bankare - anëtare të EBF-së. Brenda pesë

ditëve të para pas fillimit, totali i postimeve në mediat sociale, duke llogaritur Twitter, LinkedIn dhe Facebook, ishte 3,416, ndërsa u siguruan mbi 4,6 milionë shikime. Ky ishte vetëm fillimi! Materiali do të përdoret në mënyrë të

përsëritur në çdo rast dhe më shumë organizata, institucione dhe biznese individuale, që dëshirojnë të promovojnë fushatën, janë gjithmonë të mirëpritur t'i bashkohen asaj.

Fushata kundra mashtrimeve kibernetike është një shembull se çfarë mund të arrihet kur bashkojnë forcat sektori publik dhe ai privat. Zgjerimi i shpejtë i digjitalizimit, vëllimet e mëdha të të dhënave personale që qarkullojnë në internet dhe ndërlikohja e pashembullt e sistemeve, gjërave dhe njerëzve nuk mund të tolerojnë padijen, kur bëhet fjalë për sigurinë tonë digjitale. Julian King, komisioner për Unionin e Sigurisë, në fjalimin e tij të mbylljes në konferencën EBF-së për Sigurinë Kibernetike, vuri në dukje se nevojitet bashkëpunim më i madh publik-privat në të gjithë Europën, "si ai që po shohim sot mes Europol-it dhe Federatës Bankare Evropiane".

Në fjalimin e tij përmbyllës komisioneri për Sigurinë e Unionit, Julian King:

"Nevojitet një bashkëpunim më i madh publik-privat në të gjithë Europën për sigurinë kibernetike, si ai që po shohim sot mes Europol-it dhe Federatës Bankare Evropiane".



Problematika dhe strategjitë në kuadrin e Unionit Bankar Evropian për garantimin e depozitave dhe uljen e rrezikut të huave me probleme

Në eurozonë, modeli ekonomik e financiar i zbatuar duket se ka ndryshuar në mënyrë strukturore, në kushtet e një rritje ekonomike dhe niveli inflacioni në nivele më të ulëta se ato të konstatuara përpara krizës së 2008-ës. Për pasojë, dhjetë vite më vonë, në 2018, kapaciteti dhe mundësitë e shumë aktorëve ekonomikë, privatë apo publikë, për të ripaguar huat e tyre vlerësohet ende “problematik”.



Prof. Dr. Adrian CIVICI

President

UNIVERSITETI EUROPIAN I TIRANËS

Vendimi i vitit 2012 për krijimin e Unionit Bankar Evropian ishte përgjigje e drejtpërdrejt e BE-së, eurozonës dhe BQE-së, për minimizimin e pasojave të krizës financiare globale dhe nevojave për strategji më eficiente, për konsolidimin e hapësirës financiare evropiane, eliminimin e dobësive të sektorit bankar, forcimin e mbikëqyrjes bankare, stopimin e degradimit të financave publike, rritjen e garancisë së depozitave, etj. Unioni Bankar Evropian u mbështet në tre shtylla të rëndësishme: mekanizmi unik dhe i përbashkët i mbikëqyrjes për grupet e mëdha bankare evropiane, që do realizohej nga BQE; mekanizmi unik i zgjidhjes së krizave bankare në zonën euro;

harmonizimi i sistemit të garancive të depozitave në nivel evropian. Shtylla e tretë, “harmonizimi i sistemit të garancive të depozitave në nivel evropian”, i parashikuar



Përtej zgjidhjeve që konsistojnë në fshirjen e NPL-ve nga bilancet e bankave, provizoneve të reja, titullizimit dhe krijimit të “bad banks”, në debatet aktuale nënvizohet se është e rëndësishme që autoritetet publike në nivel evropian duhet të fokusohen në veprime e strategji më të rëndësishme, që konsistojnë në: përcaktimin më të mirë të kuadrit rregullator e institucional, zgjerimin e mbikëqyrjes bankare të BQE-së në një numër më të madh bankash evropiane, zbatimin e politikave monetare e buxhetore në nivel eurozone, me objektiv “blerjen e huave të dyshimta e problematike”, shtimi i kapitalit të bankave që gjenden në situatë të vështirë financiare, etj.



për t’u realizuar deri në vitin 2024, duket se përparon më ngadalë, për shkak të vlerësimit nga disa vende

anëtare, sidomos nga Gjermania dhe Holanda, se: “në eurozonë, rreziqet e krizave bankare janë shumë heterogjene, për të patur mundësi harmonizimi, apo unifikimi të garantimit të depozitave”. Sistemet kombëtare të garancive të depozitave bankare konsiderohen ende mjaft të prekshme kundrejt goditjeve lokale, sidomos të bankave greke, italiane dhe spanjolle. Pengesat për realizimin i këtij objektivit dhe krijimin e një tregu bankar të integruar, rezultojnë të lidhura ngushtë edhe me problematikën e Huave me probleme (Non-Performing Loans – NPL) në vende të ndryshme të eurozonës. Zgjidhja e çështjeve dhe pengesave të shkaktuara nga NPL-të po konsiderohet si një etapë e rëndësishme drejt rikthimit të besimit, për realizimin e objektivit të tregut të integruar bankar evropian.

Por, si paraqitet situata aktuale e NPL-ve në vende të ndryshme të eurozonës dhe BE-së? Mbështetur në përcaktimet e Autoritetit Bankar Evropian (dokumenti i vitit 2014: “Zbatimi i standardeve teknike mbi raportimin rregullator për ekspozimet e modifikuara dhe ato me probleme”, që synonte harmonizimin e konceptit të huave të dyshimta, apo të këqija në nivel evropian), situata më problematike rezulton në vitin 2014, kur në bilancin e bankave evropiane NPL-

PARTNERI I BIZNESIT TUAJ

KARTË KREDITI PËR BIZNESE

- ▶ Rezervo & Paguaj Online – Pa komision!
- ▶ Në EUR, LEK ose USD
- ▶ Mbrojtje ekskluzive ndaj vjedhjeve!
- ▶ Limiti Ditor në dorën tuaj



Fibank
First Investment Bank

të arritën në nivelin e 1 miliard eurove, duke shkaktuar shqetësim për rikthimin e një krize të re sistemike, që mund ta dëmtonte rëndë sektorin bankar evropian. Në fund të vitit 2017, shuma totale e huave në eurozonë arriti në 14,864 miliardë euro. Rreth 5% e kësaj shume, ose 740 miliardë euro, ishte NPL, ndërkohë që vetëm 46% e saj, ose 340 miliardë euro, ishte e provigjonuar, çka do të thotë që diferenca, pra shuma prej 400 miliardë euro, ishte e pa provigjonuar. Ndërkohë, referuar të dhënave të BQE-së për gjashtëmuorin e parë të vitit 2018, situata duket se ka evoluar pozitivisht. Përqindja e NPL-ve të bankave më të mëdha evropiane ka kaluar nga 7.3%, në fund të vitit 2015, në 4.8% në 2018, me prirje për t'u ulur edhe më shumë në muajt në vazhdim. Referuar të dhënave të vitit 2018 (European Banking Authority – Organizëm i BE-së i ngarkuar me mbikqyrjen e tregut bankar evropian), NPL-të rezultojnë ende në nivele alarmante në disa vende. Problematike paraqitet gjendja në Qipro dhe Greqi, ku NPL-të neto të provigjonuara zënë mbi 20% të PBB-së, ndërkohë që NPL-të në raport me totalin e huave janë në nivele respektive 38.9% dhe 44.9%. "Mjaft preokupuese" është dhe situata e NPL-ve në Slloveni (10.5%), Irlandë (10.4%), Itali (11.1%) dhe Portugali (10.5%), ndërkohë që NPL-të neto të provigjonuara rezultojnë në intervalin 5 - 8% të PBB-së. Në total, shuma e NPL-ve të pa provigjonuara për eurozonën është rreth 400 miliardë euro, ose ekuivalenti i 3.5% të PBB-së së eurozonës, përqindje e konsideruar si "relativisht shqetësuese". Bankat dhe huaja bankare vazhdojnë të kenë një peshë të rëndësishme në ekonominë e mjaft vendeve të BE-së dhe eurozonës. Duke përdorur treguesin "sasia e huas/PBB",

rezulton se ky tregues është mbi 200% në Qipro, Spanjë, Francë, Luksemburg dhe Hollandë; 151% në Belgjikë, 90.1% në Estoni, 78.9% në Gjermani, 37.7% në Letoni, etj.

Përtej zgjidhjeve që konsistojnë në fshirjen e NPL-ve nga bilancet e bankave, provizioneve të reja, titullizimit dhe krijimit të "bad banks", në debatet aktuale nënvizohet se është e rëndësishme që autoritetet publike në nivel evropian duhet të fokusohen në veprime e strategji më të rëndësishme, që konsistojnë në: përcaktimin më të mirë të kuadrit rregullator e institucional, zgjerimin e mbikqyrjes bankare të BQE-së në një numër më të madh bankash evropiane, zbatimin e politikave monetare e buxhetore në nivel eurozone, me objektivi "blerjen e huave të dyshimta e problematike", shtimi i kapitalit të bankave që gjenden në situatë të vështirë financiare, etj. Kriza financiare, e shpërthyer në vitin 2008 si efekt i huave hipotekore me risk të lartë, të famshmet subprime-s, evidentoi dobësitë e strukturës financiare botërore të ndërtaur mbi instrumente mbulues e mbështetës që teorikisht duhet të mbronin investuesit, por që në praktikë u tregua e paaftë të garantonte mbrojtje kundrejt shock-ut sistematik. Pasojat negative mbi ekonominë e mjaft vendeve krijuan probleme e vështirësi të shumta për aktorët ekonomikë privatë e publikë, të cilët nuk ishin në gjendje të rimbursenin huat e tyre.

Në eurozonë, modeli ekonomik e financiar i zbatuar duket se ka ndryshuar në mënyrë strukturore, në kushtet e një rritje ekonomike dhe niveli inflacioni në nivele më të ulëta se ato të konstatuara përpara krizës së 2008-ës. Për pasojë, dhjetë vite më vonë, në 2018, kapaciteti dhe mundësitë e shumë

aktorëve ekonomikë, privatë apo publikë, për të ripaguar huat e tyre vlerësohet ende "problematik". Përqindja e huave të dyshimta është zgjeruar për të arritur në nivele të larta "preokupuese" e "mjaft shqetësuese" në Greqi, Qipro, Itali dhe Portugali. Sipas ekspertëve bankarë e financiarë, një nga shpjegimet e mundshme të kësaj situatë ekonomike problematike është se kriza shkaktoi humbje të konsiderueshme financiare, një pjesë e të cilave vazhdon akoma të mos jetë e vlerësuar saktë e realisht. Këto paqartësi për vlerën reale të borxheve private e publike vazhdojnë të ushqejnë mungesë besimi në eurozonë, bile dhe më gjerë, në gjithë vendet e BE-së.

Kjo situatë konsiderohet si më "problematike" në raport me zbatimin e shtyllës së tretëtë të unionit bankar evropian, harmonizimit të sistemit të garancive të depozitave në nivel evropian. Në instancat e larta drejtuese të BE-së në Bruksel dhe në BQE vlerësojnë se, dalja nga kriza aktuale e BE-së dhe frenimi i populizmit, që kërkon shpërbërjen e Europës dhe elitave financiare e ekonomike të saj, "është i lidhur dhe me minimizimin apo mbylljen përfundimtare të kapitullit të huave të këqia". Ky është shkaku pse Gjermania, Holanda, apo ndonjë vend tjetër evropian, vazhdojnë të jenë kundër unifikimit të garancive për depozitat dhe përparimin e shpejtë të gjithë paketës institucionale të shtyllës së tretëtë të unionit bankar evropian. Ajo që po kërkohet me forcë nga gjithë vendet e eurozonës është "gjetja e zgjidhjeve konkrete dhe eficiente, për t'ju krijuar mundësi bankave, sidomos atyre të mëdha e me ndikim të konsiderueshëm në tregjet bankare, që të reduktojnë ekspozimin dhe pastrojnë llogaritë dhe bilancet e tyre nga NPL-të".

Cfarë propozohet dhe ku

po përqëndrohen përpjekjet për minimizimin e problemit të NPL-ve dhe përparimit drejt realizimit të plotë të harmonizimit të sistemit të garancive të depozitave në nivel evropian?


Së pari, në reagimin që duhet të kenë aktorët privatë të tregut bankar, për një administrim më eficient të rrezikut të shkaktuar nga prania e NPL-ve në nivele të larta. Bankat po synojnë që, në kuadër të nivelit të ekspozimit dhe respektimit të detyrimeve të bilancit, ta vlerësojnë më mirë rrezikun e mbajtjes së NPL-ve dhe humbjeve financiare që burojnë nga to; të provigjonojnë në funksion të shumës së rivlerësuar të humbjeve, në përputhje me standardin IFRS9; të shesin NPL-të në tregjet dytësore nëpërmjet operacioneve të titullizimit, operacion që iu krijon mundësi bankave të çlirojnë kapitalin e tyre rregullator dhe ta përdorin atë për garantimin e huave të reja; në përputhje me orientimet dhe rregullat e BQE për provigjnimin prudencial, të provigjonojnë në një kontekst të gjërë prudencial; të provigjonojnë në nivel 100% huat e pasiguruara; për bankat në

vështirësi, të krijojnë struktura – brenda apo jashtë bankës – të tipit bad bank për pastrimin e bilanceve të tyre nga NPL-të; të stimulojnë partneritetin publik – privat në tregjet dytësore të shitblerjes së NPL-ve; etj.

Së dyti, në reagimet që duhet të kenë autoritetet dhe institucionet publike, në kuadrin e adoptimit të unionit bankar evropian, në kuadër të të cilit mbikëqyrja nga BQE po zgjerohet në shumicën dërrmuese të bankave të eurozonës. Shtetet dhe qeveritë e ndryshme evropiane, në partneritet me investues privat, po stimulojnë të shtojnë kapitale në strukturat *bad bank*; në disa shtete evropiane institucionet publike po shtojnë garancitë dhe po rikapitalizojnë bankat në vështirësi; po marrin masa për evitimin e paniqueve bankare, duke vendosur kontrolle të përkohshme mbi kapitalet e bankave, duke kufizuar tërheqjet masive të kapitaleve, etj.; po lehtësojnë rregullat fiskale që ndikojnë në gjendjen e bilanceve të bankave dhe kapacitetet e tyre për ristrukturimin e NPL-ve, etj.

Së treti, në nivel evropian, BQE dhe Komisioni Evropian, përtej zgjerimit të sferës së

mbikëqyrjes bankare po zbaton dhe një politikë monetare më pak konvencionale, për t'i krijuar mundësi bankave të rifinancohen; po organizon testet e rezistencës, që mundësojnë vlerësimin e kapaciteteve të bankave për t'i rezistuar goditjeve të forta që vijnë nga ulja e PBB-së, rënia e çmimeve të pasurive të paluajtshme, etj.; Komisioni Evropian, nëpërmjet nismave të reja legjislativë, po synon vazhdimisht të përmirësojë legjislacionin bankar evropian; Eurogrupi nënvizon vazhdimisht se: "zgjidhja e problemeve bankare në nivel individual vendesh të zonës euro do të ishte një kontribut thelbësor në zgjidhjen e problemit të NPL-ve në nivel eurozone" duke rritur së tepërmi besimin për zbatimin praktik të harmonizimit të sistemit të garancive të depozitave në nivel evropian. Në këtë kuadër, krijimi i një buxheti specifik, apo fondi evropian për garantimin e depozitave, konsiderohet si hapi më i rëndësishëm në realizimin e shtyllës së tretë të unionit bankar evropian.



OBJEKTIVAT PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM



OBJEKTIVI 1

Më 21 dhjetor u organizua dreka për 48 fëmijët nga 226 familjet e Martirëve të Policisë së Shtetit, me pjesëmarrjen e Ministrit të Brendshëm dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.

OBJEKTIVI 2

Në Ditën e Krishtlindjes, në sheshin "Nënë Tereza", Banka iu bashkua nismës së lëvizjes Ecovolis.

OBJEKTIVI 3

Banka mbështeti:

- Veprimtaritë e organizuara nga YWCA of Albania, në kuadër të fushatës për informimin dhe ndërgjegjësimin e grave dhe vajzave për parandalimin e kancerit të gjirit.

- Maratonën e Tiranës 2018, organizuar më 7 tetor. ABI e pranishme edhe me një skuadër të madhe.

- Edicionin e parë të Maratonës së Vrapimit Malor (trial run) në malet e Voskopojës.

OBJEKTIVI 4

Banka mbështeti:

- Aktivitetin "Rruga drejt Suksesit".

- Më 14 nëntor RIT Kosova (A.U.K.) mbajti për herë të tretë veprimtarinë fondmbledhëse, në Harvard Club në New York, SHBA.

OBJEKTIVI 8

Sponsor i panairit më të madh të bujqësisë në Shqipëri, që u zhvillua në 12 - 13 tetor në Sheshin "Nënë Tereza".

OBJEKTIVI 11

Sponsor i projektit të Bashkisë Korçë: "Stacionet e Gjelbra", i cili përfundoi më 6 tetor me Festën e

Mollës, në fshatin Dvoran.

ART, SPORT, KULTURE

ABI Bank mbështet:

- Turneun "Ambël e Thartë", koncerte të cilat transmetojnë emocione artistike dhe vlerat e trashëgimisë kulturore të Shqipërisë.

- Programin "Familja".

- Koncertin me titull: "Misa Criolla", më 16 tetor në teatrin e Katedrales Ortodokse;

- Takimin mbarëkombëtar të teatrit profesionist "Kadri Roshi".

- Veprimtarinë: "Të bashkuar në muzikë dhe kujtimin e Skënderbeut" organizuar më 19 nëntor, në Vatikan.

- Turin e koncerteve: "Tinguj Kinemaje", i Orkestrës Simfonike të RTSH-së.



ALPHA BANK

Në periudhën 1-5 tetor banka shpërbleu klientët që përdorin kartat e saj, duke u ofruar 10% rimbursim të shpenzimit të kryer pranë restoranteve partnere.

OBJEKTIVI 3

Mbështeti Maratonën e Tiranës ku dhuroi çmime për fituesit e kategorive të ndryshme.

OBJEKTIVI 4

Më 2-3 nëntor mori pjesë në veprimtarinë: "Rruga Drejt Suksesit. Të ardhurat e siguruar nga shitja e biletave, shkuan për bamirësi.

OBJEKTIVI 2

Banka mbështeti:

- Veprimtarinë "Rrathë dhurues",



organizuar më 6 dhjetor nga Partners Albania, ku individë dhe biznese u bënë së bashku për të mbështetur 3 kauza sociale, të cilat synojnë përmirësimin e jetës së grupeve në nevojë.

- Edicionin e parë të "Forumit Ekonomik të Tiranës" organizuar më 7 dhjetor 2018.



OBJEKTIVI 4

Banka Kombëtare Tregtare mbështeti:

- Gjimnazin "Petro Nini Luarasi" për vënie në skenë të shfaqjes në kujtim të poetit dhe shkrimtarit të njohur shqiptar, Migjenit, me rastin e 80-vjetorit të ndarjes së tij nga jeta.

- Universitetin "Luigj Gurakuqi" në organizimin një grupi veprimtarish gjatë 5 ditëve, në lidhje me 25-vjetorin e hapjes.

- Shkollën 9-vjeçare "Gjon Ndoci", Bushat duke sponsorizuar për blerjen e pajisjeve elektronike për të përmirësuar mësimdhënien.

- Qendrën e Zhvillimit "Pëllumbat", fëmijët e të cilës edhe këtë vit i festuan festat e fundvitit së bashku me stafin e bankës.

- Universitetin "Aleksandër Moisiu", Durrës (UAMD) që organizoi ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Studimeve të Integruara me Praktikën (FASTIP).

OBJEKTIVI 9

Bashkia Librazhd, IEVP Peqin & ARSHVMB Elbasan

Banka dhuroi pajisje për të përmirësuar infrastrukturën e IT dhe nxitur inovacionin teknologjik në këto institucione.

OBJEKTIVI 15

Green Line Albania
Banka në bashkëpunim me Green Line Albania organizoi aksionin e pastrimit në datë 23 Nëntor të gjitha trevat e Shqipërisë për t'u kujdesur për çdo gjë që na rrethon.



OBJEKTIVI 16

Ambasada e Republikës së Shqipërisë në Ankara
Banka mbështeti financiarisht organizimin e një feste me rastin e Ditës së Pavarësisë së Shqipërisë në datë 28 nëntor.



OBJEKTIVI 2

Vazhdoi mbulimin e shpenzimeve për 3 fëmijë në fshatin SOS.



OBJEKTIVI 4

Në Ditën Ndërkombëtare të Kursimit, ishte pranë nxënësve të shkollave 9-Vjeçare "Kushtrimi i Lirisë" dhe "Shkolla e Kuqe" dhe dhuroi 1,500 fletore, në të cilat integrohej edhe një udhëzues financiar "Unë di të Kursej" për prindërit dhe fëmijët.



OBJEKTIVI 9

Banka mbështeti Rezidencën Studentore Universitare Nr.2 sh.a, Shkollën "Isa Boletini", IEVP Fushë Krujë, DRSH Dibër dhe Qendrën Shëndetësore Nr.1, duke restauruar dhe dhuruar pajisje për përmirësimin e kushteve të brendshme dhe për mjediset e brendshme të këtyre institucioneve.



- Dhuroi pajisje zyre në përmirësimin e kushteve fizike të institucioneve: AZHBR, Ujësjellës - Kanalizime Mallakastër, Trajtimi i Studentëve, Shtëpia e Pushimit Ministria e Brendshme, Qendrën Shëndetësore Nr.8 si dhe Klubi Shumësportësh "Studenti".



OBJEKTIVI 10

Bashkëpunoi me Down Syndrome Albania dhe "SOS Fshatrat e Fëmijëve Shqiptarë" dhe bleu kartolinat e fund-vitit pranë këtyre fondacioneve.

OBJEKTIVI 11

Mbështeti Shoqatën "Orafilm – Marubi sh.p.k", duke mbuluar shpenzimet e projektit: "Festivali Ndërkombëtar i Filmit për të Drejtat e Njeriut në Shqipëri – Edicioni 13".

KULTURË, ART DHE SPORT

Sponsorizoi Aeronatikën Shqiptare, në organizimin e "Korça Open Air".

**OBJEKTIVI 1**

Më 18 tetor, në kuadër të Ditës Ndërkombëtare Kundër Varfërisë punonjësit e bankës u organizuan me personazhe të njohur të showbizit shqiptar dhe vullnetarët e Kryqit të Kuq, duke ofruar bujarisht shërbimin e tyre për këtë pjesë kaq vunerabël të shoqërisë.

OBJEKTIVI 3

- Më 7 tetor 2018 banka u bë pjesë e Edicionit të 3-të të Maratonës së Tiranës me 20 pjesmarrës – pjesë e stafit të Fibank .

- Më 19 dhjetor, banka iu bashkua kauzës së dhurimit të gjakut.

OBJEKTIVI 5

Banka erdhinë ndihmë të Fondacionit Spitalor të Nënës & Fëmijës, duke blerë kartolinat e fund-vitit.

**OBJEKTIVI 3**

- Në datat 6 dhe 7 dhjetor, Intesa Sanpaolo Bank Albania organizoi nismën e dytë të dhurimit vullnetar të gjakut për vitin 2018.

- Banka mbështeti financiarisht nismën kombëtare të Green Line, në veprimtarinë: "Let's Do it! Ta Pastrojmë Shqipërinë në 1 Ditë", më 23 nëntor 2018, në disa qytete të Shqipërisë.

OBJEKTIVI 4

Banka iu bashkua për të dytin vit rradhazi nismës së suksesshme ndërkombëtare të Grupit Intesa Sanpaolo & Muzeut të Kursimit (Museo del Risparmio), Galerive Italiane (Gallerie d'Italia) dhe Arkivës Historike, për të festuar së bashku Ditën Botërore të Kursimit në 31 tetor 2018.

OBJEKTIVI 5

Banka u bashkua me fushatën ndërkombëtare: "16 Ditët e Aktivizmit kundër Dhunës me Bazë Gjimore", që u zhvillua nga data 25 nëntor (Dita Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës ndaj Grave), deri në 10 dhjetor (Dita e Ndërkombëtare e të Drejtave të Njeriut), duke sjellë mesazhin e "Tolerancës Zero për dhunën ndaj Grave dhe Vajzave".

OBJEKTIVI 9

Më 16 nëntor Banka mirëpriti në degën e saj të rikonstruktuar së fundmi në Rr. Barrikadave një grup studentësh të vitit të tretë për Ekonomi - Ndërmarrje të Universitetit Katolik "Zonja e Këshillit të Mirë" në Tiranë.

OBJEKTIVI 10

Banka mori pjesë në veprimtarinë e zhvilluar nga Universiteti Metropolitan i Tiranës, ku prezantoi ofertën speciale krijuar për mbajtësit e Kartës së Studentit të UMT-së.

OBJEKTIVI 11

Banka mbështeti financiarisht "Konferencën e Turizmit 2018", veprimtari e organizuar nga FIAA më 27 nëntor.



OBJEKTIVI 12

Banka mbështeti projektin: "Shqipëria Punon Tokën - Konsumo Shqip", i cili ka për qëllim unifikimin e produkteve shqiptare në një hapësirë të përbashkët.

**OBJEKTIVI 1**

U blenë 1,000 kartolina, të pikturuara nga SOS Fshatrat e Fëmijëve.

OBJEKTIVI 7

Me nismë të Bankës ProCredit, u organizua një takim me biznese të interesuar për realizimin e investimeve në Impiante Fotovoltaike.

OBJEKTIVI 13

U risoll në nëntor një fushatë të brendshme, nën moton: "Mendo Eko". Qëllimi i fushatës është që stafi nëpërmjet informimit dhe ndërgjegjësimit të kthejë në sjellje përdorimin e praktikave eko.

OBJEKTIVI 17

ProCredit Bank mbështeti zhvillimin e veprimtarive të ndryshme, në kuadër të "Tetorit Gjerman": "Frymëzuar nga Njerëzit", sërë veprimtarish, si: teatër, ekspozita, filma, takime dhe diskutime të ndryshme. Ajo gjithashtu mbështeti edhe DIHA Oktober Fest.

**OBJEKTIVI 3**

Banka mbështeti edicionin e tretë të konferencës All Web për

marketingun digjital ku morën pjesë 13 folës të shkëlqyeshëm në skenë.

• Raiffeisen Invest mbështeti: "Linja e këshillimit për gra dhe vajza", në veprimtaritë e tyre për rritjen e ndërgjegjësimit sjellë përmes ekspozitës që paraqiti Gjeneratën A në Shqipëri me një fokus të veçantë në gratë dhe vajzat.

ART dhe KULTURE

Raiffeisen Bank mbështeti projektet e Teatri i Operas dhe Baletit në disa veprimtari cilësore, të mirëpritur nga publiku artdashës, si: baleti "Zhizel", koncerti "Të gjithë e duam Agim Krajkën", shfaqjen "TAG", etj.

Raiffeisen Invest mbështet çdo vit Pianodrom-in, i cili filloi në tetor dhe përfundoi në 17 dhjetor. "Tre tenorët", një tjetër traditë e bukur kjo, erdhi me sukses në Tiranë.


**OBJEKTIVI 3**

Banka zgjodhi të urojë klientët dhe bashkëpunëtorët e saj nëpërmjet kartolinave të përgatitura nga Fondacioni Spitalor "Nëna dhe Fëmija".

OBJEKTIVI 7

• Sektori privat i ndërtimit dhe rezidencial në Shqipëri do të përfitojë nga një akses më i gjerë në financim, falë huas prej 6 milionë Euro që Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) i mundëson Union Bank Albania.

• Në datat 5-6 tetor, me mbështetjen e Union Bank, u zhvillua në Tiranë edicioni i dytë i panairit: "Energy Expo & Forum 2018".



AAB AKTIVITETE

Seminar mbi zhvillimin e karrierës
12 tetor 2018

Takim-diskutimi mbi sigurinë kibernetike
18 tetor 2018

Udhëtim trajnimi me gazetarët ekonomikë
2-4 nëntor 2018

Mbështetur nga Banka Amerikane e
Investimeve (ABI Bank) dhe Union Bank.

Takim-diskutimi mbi rregullimin e
mbrojtjes së të dhënave personale në
sistemin bankar
7 nëntor 2018

Takim-diskutimi mbi kërkesat rregullatorë,
lidhur me rolin e auditit të brendshëm në
banka
16 nëntor 2018

Takim-diskutimi në bashkëpunim me
KOBIL Systems, digjitalizimi: Si mund të
bëhemi një bankë plotësisht digjitale
21 nëntor 2018

Darka e Vitit të Ri

Më 12 dhjetor, AAB organizoi Darkën e Fundvitit, ku morën pjesë drejtorët e përgjithshëm të bankave dhe kryetarët e komisioneve teknike të AAB-së, Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Zëvendëskryeministrja, Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave dhe Informimit dhe Drejtori i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave.

Ceremoni përcjellje

AAB organizoi një ceremoni përcjellje për Z. Frederic Blanc, që përfundoi mandatin e tij si Drejtor i Përgjithshëm i Bankës Société Générale Albania.

Marrëveshjet e Bashkëpunimit

- Më 17 dhjetor 2018 u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit midis Shoqatës Shqiptare të Bankave (AAB) dhe Agjencisë së Sigurimit të Depozitave (ASD).
- Më 21 dhjetor, u nënshkrua Marrëveshja e Bashkëpunimit me Institutin Shqiptar të Audituesve të Brendshëm (AIIA).

TRAJNIME

AAB organizon trajnime Tetor - Dhjetor 2018

Ndërtimi i Ekipit

8-11 tetor 2018, trajnim 4 ditor mbi: "Puna në grup - Ndërtimi dhe drejtimi i një ekipi fitues" nën drejtimin e trajneres Gila Yaniv.

Menaxhimi i Sigurisë Kibernetike dhe Informacionit

15 - 17 tetor 2018, trajnim në bashkëpunim me HoT, Luksemburg (ATTF).

Menaxheri si Trajnues

17-19 tetor 2018, trajnim ndërveprues, i organizuar në bashkëpunim me AIEEx.

Drejtimin përmes inteligjencës emocionale

12-13 nëntor 2018, trajnim dy-ditor ndërveprues, i organizuar në bashkëpunim me AIEEx.

Identifikimi i krimit financiar, nëpërmjet kujdesit të shtuar për parandalimin e pastrimit të parave

12-13 nëntor 2018, trajnim i organizuar në bashkëpunim me AIIA dhe mbështetur nga ekspertë vendas të Njësisë së Inteligjencës Financiare.

Menaxhimi i stafit për menaxherët e ekipit

4-6 dhjetor 2018, trajnim me ushtrime praktike nga Gilles de Mendez, ekspert i ATTF, Lux.



